



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORE

Numri i Ceshtjes :	58339-00438-61-2018	Data e Regjistrimit :	13/02/2018
Numri i Vendimit:	61-2018-5995	Data e Vendimit :	15/11/2018

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORE E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: Laurent Fuçia

SEKRETARE: Dolores Radhima

Sot më datë 15/11/2018 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

Të pandehurit: Xxx, i biri i x dhe i x i datëlindjes x

Akuzuar: Gjykim i procedimit penalN r. x ne ngarkim te te pandehurit Xxx x

VEREN :

Vëren:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
VLORË

NR.242 AKTI
DT.ARDHJES 13.02.2018

NR.505 VENDIMI
DT.VENDIMIT 15.11.2018

V E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, me trup gjykues të përbërë prej:

GJYQTAR: LAURENT FUÇIA

GJYQTARE: ATALANTA ZEQRRAJ

GJYQTARE: ARBANA SELMANAJ

Me pjesmarrjen e sekretares gjyqësore Dolores Zemanaj, sot në Vlorë, më datë 15.11.2018, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen penale me Nr.242 Akti, me palë:

KËRKUESE: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, përfaqësuar nga xxx

E PANDEHUR: xxx), e bija e x dhe e x e datëlindjes 06

x dhe banuese në Vlorë, Lagjia "xi", Rruga "Dx", banesa x, me shtetësi shqiptare, me gjendje civile e martuar, me arsim katër klasë, e padënuar më parë, e hetuar dhe gjykuar në gjendje të lirë, e mbrojtur nga avokati i zgjedhur me prokurë, Av.x.

E AKUZUAR: Për kryerjen e veprave penale të "Falsifikimit të doxxxnteve" të kryer lëshojë doxxxntin, të kryer katër herë dhe në bashkëpunim, "Shpërdorimit të detyrës", "Ndërtimi i paligjshëm" të kryer në tokën e tjetrit

dhe në tokën shtetërore, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 186/3 e 25, 248 dhe 199a/2 e 25 të Kodit Penal.

Gjykata, pasi administroi aktet e ndodhura në dosjen gjyqësore, e

shqyrtoi çështjen në tërësi, dëgjoi diskutimet përfundimtare të palëve,

të cilat kërkuan:

-Pala akuzuese, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, përfaqësuar nga Prokurori z.xx kërkoi: "Deklarimin fajtor të të pandehurës Xxx, për kryerjen e veprës penale "Falsifikimi i doxxxnteve", të kryer më shumë se një herë, përmes përdorimit të doxxxntit të falsifikuar dhe në bashkëpunim, parashikuar si vepër penale nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 4 (katër) vite burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurës Xxx, për kryerjen e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", që ka sjellë pasoja të rënda, parashikuar nga neni 287/3 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vite burgim. Në aplikim të nenit 55 të K.Penal në bashkim të dënimeve, dënimin përfundimtar të pandehurës Xxx me 18 (tetëmbëdhjetë) vite burgim. Gjykata në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, të ulë një të tretën e masës së dënimit të dhënë.Në aplikim të neneve 190/1 dhe 391 të K.Pr.Penale, të deklarohej falsiteti i doxxxnteve që i janë bashkuar fashikullit të gjykimin dhe të disponohet në lidhje me to, e konkretisht në lidhje me këto doxxxnte: Dosjen gjyqësore civile me numër vendimi xxx, datë 23/12/1996, numër regjistri themeltar xxx, datë regjistrimi 10/04/1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me paditës Xxx, palë e paditur K.K.K.Pronave të rrethit Vlorë, me objekt anulim vendimi, gjyqyarë xx, sekretare gjyqësore xx, të deklarohej e falsifikuar, por mos të urdhërohet asgjësimi i saj, për faktin se mbajtja e kësaj prove është e nevojshme në kuadër të procedimit penal nrxx të vitit 2017, në kuadër të të cilit po hetohet mënyra e administrimit të kësaj dosje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe personat që kanë shkruar dhe dorëshkuar në këtë dosje gjyqësore. Dosjen gjyqësore civile me numër vendimi x datë x, numër regjistri x datë 24/12/1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me kërkuese Xxx, të deklarohej e falsifikuar, por mos të urdhërohet asgjësimi i saj, për faktin se mbajtja e kësaj prove është e nevojshme në kuadër të procedimit penal nr. 2159 të vitit 2017, në kuadër të të cilit po hetohet mënyra e administrimit të kësaj dosje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe personat që kanë shkruar dhe dorëshkuar në këtë dosje gjyqësore. Të dhënat e pasqyruara në Nuratorin Civil ku gjenden të pasqyruara vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për periudhën nga muaji nëntor i vitit 1996, i vitit 1997 dhe vitit 1998, e konkretisht të dhënat e pasqyruara në lidhje me vendimet gjyqësore vendimi x, datë x, numër regjistri themeltar x, datë regjistrimi x i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe vendimi x, datë

x, numër regjistri x, datë x i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të deklarohej e falsifikuar, por mos të urdhërohet fshirja e tyre, për faktin se mbajtja e kësaj prove është e nevojshme në kuadër të procedimit penal nr. x të vitit 2017, në kuadër të të cilit po hetohet mënyra e administrimit të kësaj dosje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe personat që kanë shkruar dhe dorëshkuar në këtë dosje gjyqësore.

Të dhënat e pasqyruara në Regjistrin Themeltar i vitit 1996 në lidhje me të dhënat e vendimit nr. x, datë

x, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të deklarohej e falsifikuar, por mos të urdhërohet fshirja e tyre, për faktin se mbajtja e kësaj prove është e nevojshme në kuadër të procedimit penal nr. x të vitit 2017, në kuadër të të cilit po hetohet mënyra e administrimit të kësaj dosje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe personat që kanë shkruar dhe dorëshkuar në këtë dosje gjyqësore. Në bazë të nenit 36/b të Kodit Penal, të konsfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit dhe të fshihen nga regjistri i ZVRPP Vlorë, produktet e veprës penale të "Falsifikimit të doxxxnteve", të cilat janë nën masën e sigurimit të sekuestros preventive me vendimin nr.x datë 29/05/2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e konkretisht të: Pasurisë nr. x, vol.x, faqe x, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 22.000

m², regjistruar në emër të shtetases Xxx (xx). Pasurisë nr. x, vol.x, faqe x, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 10.000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx. Pasurisë nr. x, vol.x, faqe x, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 6.000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx (x). Pasurisë nr. x, vol.xx faqe xx, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 4.000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx (x). Pasurisë nr. , vol.xx, faqe ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 7000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx xxx. Pasurisë nr. x, vol.x, faqe x, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 11.000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx (x dhe x. Pasurisë nr. x, vol.x, faqe x ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 5000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx (x. Pasurisë nr. x, vol.x, faqe x ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 2000 m², regjistruar në emër të shtetaset x. Pasurisë nr. x, vol.x faqe xZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 2000 m², regjistruar në emër të shtetaset x. Pasurisë nr. x, vol.x, faqe x ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 500 m², regjistruar në emër të shtetaset x x, vol.x, faqe x ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 500 m², regjistruar në emër të shtetaset x. Pasurisë nr. x, vol.x, faqe x, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 30.000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx (x). Shpenzimet procedurale të kryera gjatë hetimit paraprak në shumën prej 165.000 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë) Lekë, si dhe ato të kryera gjatë gjykimit, t'i ngarkohen të pandehurës Xxx.”

-Mbrojtësi i të pandehurës Xxx Av.x kërkoi: “Deklarimin të pafajshme të pandehurës për veprat penale për të cilat ajo është akuzuar dhe sjellë për gjykim dhe konkretisht, për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 186/2 dhe 287/3 të Kodit Penal, pasi nuk u provua se e pandehura i ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar. Pushimin e çështjes penale për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe në mënyrë alterantive, nëse gjykata e deklaron fajtorë të pandehurën për veprat penale për të cilat ajo është akuzuar, të caktojë ndaj saj një masë dënimi me burgim në minimumin e parashikuar nga dispozitat penale dhe aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, duke e vendosur në provë të pandehurën për një periudhë kohore prej 2(dy) vitesh”.

VËREN:

I.Rrethanat e faktit.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ka paraqitur përpara kësaj gjykate kërkesën për gjykim, me objekt “Gjykimin e procedimit penal Nr.xxx të vitit 2016, në ngarkim të pandehurës Xxx, e akuzuar për kryerjen e veprave penale të “Falsifikimit të doxxxntave” të kryer më shumë se një herë dhe në bashkëpunim dhe “Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale”, të parashikuara respektivisht nga nenet 186/2 dhe 287/3 të Kodit Penal”.

Në seancën paraprake, nga ana e të pandehurës Xxx, në bazë të nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale, është parashtruar kërkesa për të proceduar me ritin e posaçëm të gjykimit të shkurtuar, duke menduar se çështja mund të zgjidhet në gjëndjen në të cilën ndodheshin e aktet e procedimit penal Nr.501 të vitit 2016.

Gjykata, pasi konstatoi faktin se, kërkesa e të pandehurës për të proceduar me gjykim të shkurtuar, ishte paraqitur në momentin duhur procedural[1], e deklaroi të hapur diskutimin, mori mendimin e prokurorit z.xxx, i cili u shpreh se ishte dakort me kërkesën e të pandehurës për gjykim të shkurtuar dhe pas shqyrtimit tërësor të të gjitha akteve të ndodhura në fashikullin e gjykimit, ku konstatoi se ato nuk përmbanin ndonjë shkak për pavlefshmëri absolute apo nuk ndodheshin përpara provave të papërdorshme (neni 405/7 i K.Pr.Penale), vlerësoi se bazuar në nenin 405 të Kodit të Procedurës Penale, kishte vend për të proceduar me gjykim të shkurtuar, pasi çmoi se çështja mund të zgjidhet në gjëndjen që janë aktet pa cënuar drejtësinë dhe interesat e ligjshëm të pandehurit, si dhe duke garantuar parimin e ekonomisë gjyqësore.[2]

Gjykata, në marrjen e vendimit për lejimin procedimin me ritin e gjykimit të shkurtuar ndaj të pandehurës x (x), mban në konsideratë edhe standartin kushtetues vendosur nga Gjykata Kushtetuese në Vendimin Nr.4, datë 10.02.2012, ku konkretisht theksohet se: “Nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, edhe në rastin kur procedohet me gjykim të shkurtuar, njësoj si në gjykimin e zakonshëm, do të mund të bëjnë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale dhe të dënojnë të pandehurin për një vepër penale të ndryshme dhe me një masë dënimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori, instituti do të humbiste çfarëdolloj justifikimi kushtetues, për arsye se i pandehuri, duke hequr dorë në mënyrë të vullnetshme nga disa parime kushtetuese si parimi i barazisë së armëve dhe nga parimi i kontradiktoritetit, do të sakrifikonte të drejtat e tij kushtetuese jo vetëm pa pasur asnjë lloj përfitimi, por edhe duke marrë një dënim më të lartë nga ai që priste.”

Nga tërësia e veprimeve hetimore, të kryera nga ana e organit të akuzës, në kuadër të procedimit penal Nr.x të vitit 2016, në ngarkim të pandehurës Xxx, kanë rezultuar rrethanat e faktit si më poshtë vijon:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ka regjistruar procedimin penal me nr.x viti 2016. Ky procedim penal është regjistruar mbi bazën e vendimit të ndarjes të marrë në kuadër të procedimit penal nr. x të vitit 2015. Objekt i hetimit të këtij procedimi penal është edhe dosja gjyqësore që i përket vendimit civil nr. x, datë x të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; dosja gjyqësore që i përket vendimit civil nr. x, datë x të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; doxxxntacioni që është administruar në këto dosje gjyqësore, origjina e pasurisë, regjistrimi i kësaj pasurie në ZVRPP Vlorë, si dhe veprimet e kryera në lidhje me këto pasuri. Më datën 22/05/2017 në regjistrat e njoftimit të veprave penale është regjistruar emri i shtetases xx, si personi që i atribuohet kryerja e veprave penale të parashikuara nga nenet 186/2 dhe 287 të Kodit Penal.

Nga hetimet paraprake ka rezultuar e provuar se, e pandehura Xxx, ka përfituar përmes doxxxnteve të falsifikuara një sipërfaqe pasurie të paluajtshme prej 52.000 m², e llojit pyll, e cila ndodhet në lagjen “Xxx” të Vlorës. Provohet se kjo pasuri është regjistruar në regjistrat publik pranë ZVRPP Vlorë, si dhe janë kryer veprime juridike tjetërsimi mbi këtë pasuri me qëllim fshehjen e origjinës së paligjshme të pasurisë. Ka rezultuar e provuar se dosja gjyqësore që i përket vendimit civil nr. xxx, datë 23/12/1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe dosja gjyqësore që i përket vendimit civil nr. x datë x të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, doxxxnte këto që kanë shërbyer për regjistrimin e kësaj pasurie, janë falsifikuar dhe futur në kundërshtim me ligjin në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ky fakt është provuar nga akti i ekspertimit tekniko-grafik nr. 4791, datë 11/05/2017, si dhe

nga të dhënat e administruara pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Agjencisë së Trajtit të Pronave Tiranë. Rezulton e provuar se pas përfitimit të kësaj prone, e pandehura Xxx ka kryer investime në këtë pronë, duke e rrethuar sipërfaqen e pronës prej 30.000 m², si dhe duke ndërtuar pesë kabina me konstruksion druri me sipërfaqe rreth 36 m² dhe me përmasa 6 x 6 m, si dhe një lokal me konstruksion druri.

Ka rezultuar e provuar se përmes vendimit civil nr. x, datë x të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili është tërësisht i falsifikuar, është pasqyruar fakti sikur i janë kthyer në natyrë shtetases Xxx dy parcela të lira, njëra 30.000 m² në lagjen x, me kufij të rinj V-Pyll, dhe rrugë, L- Pyll, J-Deti, P-Pyll dhe parcela e dytë me sipërfaqe 22.000 m² në x të Vlorës me kufij të rinj V-Pyll dhe rrugë, L-Pyll, J-Deti, P-Pyll, pronë e cila ndodhet në bregdet në zonën e xx, Vlorë. Rezulton e provuar se edhe vendimi civil nr. x, datë x i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është tërësisht i falsifikuar, ku përmes së cilit është pasqyruar fakti sikur është lëshuar urdhëri i ekzekutimit për vendimin nr. x datë x të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga hetimi është provuar se pasuria e mësipërme me sipërfaqe 52.000 m² është regjistruar më datë 21/03/2013, pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë. Regjistrimi i kësaj pasurie është kryer mbi bazën e doxxxnteve të falsifikuara, e konkretisht dy dosjeve të mësipërme gjyqësore, të cilat i janë shërbyer aplikuesit më datën 09/01/2013, nga arkiva e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas regjistrimit të kësaj pasurie, janë kryer veprime juridike mbi këtë pasuri, e konkretisht ndarje, shitje dhe dhurime, me qëllim fshehjen e paligjshme të origjinës së kësaj pasurie. Mbi bazën e kërkesës së prokurorit, me vendimin nr.x, datë x, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventive”, për pasuritë e paluajtshme me sipërfaqe 52.000 m².

Rrethanat e faktet e mësipërme janë provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm nga provat e administruara gjatë hetimeve paraprake, e konkretisht:

Aktet që i përkasin dosjes gjyqësore nr. x, datë x të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të cilat janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale. Nga sekuestrimi kësaj dosje gjyqësore rezulton se është pasqyruar fakti se shtetasja Xxx ka paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, padi e cila është regjistruar me nr. x të regjistrimit themeltar. Përmes kësaj padie është kërkuar anulimi i vendimit nr. x, datë x të KKK Pronave Vlorë, duke paditur Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë. Nga aktet e kësaj dosje është pasqyruar fakti se kjo padi është gjykuar nga gjyqtari x me ndihmës gjyqtarët x e x dhe me praninë e sekretares gjyqësore x.

Rezulton se, është pasqyruar fakti sikur me vendimin nr. x, datë x të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur pranimi i padisë se shtetasja Xxx, duke kthyer në natyrë dy parcela të lira, njëra 30.000 m² në lagjen x Vlorë, me kufij të rinj V-Pyll, dhe rrugë, L- Pyll, J-Deti, P-Pyll dhe parcela e dytë me sipërfaqe 22.000 m² në x të Vlorës me kufij të rinj V-Pyll dhe rrugë, L-Pyll, J-Deti, P-Pyll, sipas skicave të ndodhura në dosje.

Provohet se në këtë dosje gjyqësore është administruar si doxxxnt pronësie vendimi nr. x datë x i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë, bashkë me planimetrinë e pronës. Përmes këtij vendimi është vendosur: “1. Të njohë z. Xxx si trashëgimtare ligjore e vetme të ish pronarit x për pronën, sipërfaqe pyll prej 67.400 m², ndodhur në x Vlorë me kufij të vjetër: V-x, J-Deti, L-xi, P-Ranishte. 2. Kompensimin e sipërfaqes 67.400 m² ndodhur në xe Vlorë sipas disponibilitetit të këtij Komisioni”. Në përmbajtjen e këtij vendimi është përshkruar se vendimi i përket dosjes nr. x datë x dhe se prona e njohur është fiksuar në akt njoftuni Zotnimi nr. x, rendor, datë x.

Bazuar në shkresën nr. x prot, datë x të Agjencisë së Trajtit të Pronave dhe doxxxntacionin e administruar, rezulton se dosja nr. x, datë x, e cila përmban vendimin nr. xx2, datë 09/03/1995 të ish-KKKP-së, Këshilli i Rrethit Vlorë, i përket subjektit Hysen Rrapushi dhe jo subjektit x. Ndërsa sipas shkresës nr. x prot, datë 02/03/2017 të ZVRPP Vlorë, rezulton se pranë këtij institucioni nuk ekzistojnë akt-njoftuni të veçanta. Nga verifikimi në ideksin alfabetik nga gërma Q-ZH, në gërmen S, nuk figuron pronë në emër të x. Bazuar në shkresën nr. x prot, datë x të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, rezulton se pranë këtij institucioni nuk është administruar doxxxnti Akt Njoftuni Zotnimi me numër renduer x, datë 27/06/1938 në emër të x.

Në funksion të hetimit është vendosur kryerja e ekspertimit tekniko-grafik në lidhje me dosjen gjyqësore që që i përket vendimit civil nr. x datë x të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Bazuar në aktin e ekspertimit tekniko-grafik nr. x, datë 11/05/2017 rezulton se: “1.Dorëshkrimet në kapakun parë dhe dorëshkrimet nga faqja nr.10 deri në faqen nr. x, të dosjes gjyqësore nr. x datë regjistrimi x dhe nr.vendimi xx5, datë x objekt ekspertimi, nuk janë shkruar nga shtetasja x, krahasuar me dorëshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj. 2.Nënshkrimet (firmat) poshtë rekuizitës “Sekretare”, që ndodhen në faqen e pasme të kapakut të dosjes, në faqen e pasme të fletës nr. x, në faqen e pasme të fletës nr. x, në faqen e pasme të fletës nr.

x, në faqen e pasme të fletës nr. x në fletën nr. 19, si dhe në fletën nr. 21, doxxxnte këto që ndodhen në dosjen gjyqësore me nr. Regj. Them. x data e regjistrimit 10/04/1996 dhe nr.vendimi x datë x objekte ekspertimi, nuk janë nënshkrime (firma) të shtetasës x krahasuar me modelet e krahasimit të sjella në emër të saj. 3.Nënshkrimet (firmat) poshtë rekuizitës “Gjyqtari”, që ndodhen në faqen nr. 8, në faqen e pasme të fletës nr. 11, në faqen e pasme të fletës nr.12, në fletën nr. 14, në faqen e pasme të fletës nr. 15, në faqen e pasme të fletës nr. 17, në fletën nr. 19, si dhe në fletën nr. 21, doxxxnte këto që ndodhen në dosjen gjyqësore me nr. Regj. Them. x data e regjistrimit 10/04/1996 dhe nr.vendimi x datë 23/12/1996 objekte ekspertimi, nuk janë nënshkrime (firma) të shtetasit x, krahasuar me modelet e krahasimit të sjella në emër të tij. 4.Nënshkrimi (fimra) poshtë rekuizitës “Gjyqtari” në doxxxntin vendim nr. x, datë x të dosjes gjyqësore me nr. Regj. Them. x data e regjistrimit 10/04/1996, objekt ekspertimi, nuk është nënshkrim (firmë) i/e shtetasit Qax krahasuar me modelet e krahasimit të sjella në emër të tij.

5.Nënshkrimi (firma) poshtë rekuizitës “Sekretare”, në doxxxntin vendim nr. x datë x të dosjes gjyqësore me nr. Regj. Them. x, data e regjistrimit 10/04/1996, objekt ekspertimi, nuk është nënshkrim (firmë) i/e shtetasës x, krahasuar me modelet e krahasimit të sjella në emër të saj”.

Në funksion të hetimit është vendosur kryerja e ekspertimit grafik në lidhje me dosjen gjyqësore me nr. akti x, data e regjistrimit 24/12/1997 dhe nr. vendimi x datë x, me kërkues Xxx K dosjen gjyqësore me nr. Regj. Them x data e regjistrimit 10/04/1996 dhe nr. vendimi x, datë 23/12/1996, me kërkues Xxx Kamberaj; numratorin civil ku gjenden të pasqyruara vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për periudhën nga muaji nëntor i vitit 1996, vitit 1997 dhe vitit 1998; regjistrin themeltar i vitit 1996, që ka në përbërje të dhënat e vendimit nr. x, datë x, i cili ka nr. Themeltar x, me datë regjistrimi

x, si dhe regjistrin themeltar i vitit x, që ka në përbërje të dhënat e vendimit nr. x, datë 29/12/1997, i cili ka nr. Themeltar x me datë regjistrimi x.

Bazuar në aktin e ekspertimit grafik nr. x datë 22/08/2017, rezulton se: *“1.Dorëshkrimet në doxxxntet e plotësuara nga sekretarja gjyqësore në fletët e numërtuara “10” deri “21”, të dosjes gjyqësore me nr. Regj. Them. x datë regjistrimi 10.04.96 dhe numër vendimi xxx, datë 23.12.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, objekt ekspertimi, nuk duhet të jenë shkruar nga shtetasja x (x), krahasuar me dorëshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj. 2.Nënshkrimet (firmat) në doxxxntet e nënshkruara nga sekretarja gjyqësore të dosjes gjyqësore me nr.Regj. Them x, datë regjistrimi 10.04.96 dhe numër vendimi xxx, datë 23.12.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, objekt ekspertimi, nuk janë nënshkrime të shtetases Xxx, krahasuar me nënshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj. Nëse këto nënshkrime janë plotësuar ose jo nga shtetasja Xxx, nuk mund të konkludojmë.*

3.Dorëshkrimet në doxxxntet e plotësuara në sekretarja gjyqësore, në fletët e numërtuara “3” deri “5” të dosjes gjyqësore me nr. Regj. Them x, datë x dhe nr. vendimi x datë 24.12.1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, objekt ekspertimi, duhet të jenë shkruar nga shtetasja Xxx, krahasuar me dorëshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj. 4.Nënshkrimet (firmat) në doxxxntet e nënshkruara nga sekretarja gjyqësore të dosjes gjyqësore me nr. Regj. Them x, datë 24.12.97 dhe nr. vendimi x, datë 24.12.1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, objekt ekspertimi, nuk janë nënshkrime të shtetases Xxx, krahasuar me nënshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj. Nëse këto nënshkrime janë plotësuar ose jo nga shtetasja Xxx, nuk mund të konkludojmë.

5.Dorëshkrimet që ndodhen në regjistrin e emërtuar “Numratori civil”, e konkretisht në rreshtin e faqes që pasqyrojnë të dhënat e vendimit nr. x, datë x, objekt ekspertimi, duhet të jenë shkruar nga shtetasja Xxx, krahasuar me dorëshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj. 6.Dorëshkrimet që ndodhen në regjistrin e emërtuar “Numratori civil”, e konkretisht në rreshtin e faqes që pasqyrojnë të dhënat

e vendimit nr. 960, datë 29/12/1996, objekt ekspertimi, duhet të jenë shkruar nga shtetasja Xxx (x, krahasuar me dorëshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj. 7.Fleta me Nr.Rendor 1x, datë e regjistrimit 10.04.96, që ka në përbërje të dhënat e vendimit x datë 23.12.96 (fleta e fundit e këtij regjistri)m në Regjistrin Themeltar të vitit 1996, nuk është me të njëjtat përmasa me fletët e tjera të regjistrin dhe nuk është e lidhur me fletët e tjera të regjistrin. 8.Në plotësimin e dorëshkrimeve që kanë në përbërje të dhënat e vendimit nr. x, datë 23/12/1996, në fletën me nr.Themeltar x, datë regjistrimi 10.04.1996 (fleta e fundit e këtij regjistri), në Regjistrin Themeltar të vitit 1996, objekt ekspertimi, nuk u identifikuan ndërhyrje falsifikuese si shtesa, korigjime, fshirje, etj.

9.Dorëshkrimet që kanë në përbërje të dhënat e vendimit nr. x datë 23/12/1996, në faqen me Nr. Rendor xxx, datë regjistrimi 10.04.1996 (fleta e fundit e këtij blloku) në Regjistrin Themeltar të vitit 1996, objekt ekspertimi, duhet të jenë shkruar nga shtetasja Xxx, krahasuar me dorëshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj. 10.Dorëshkrimet që kanë në përbërje të dhëna te vendimit nr. xx, datë x në faqen me Nr.Rendor x data e regjistrimit x në Regjistrin Themeltar i vitit 1997, objekt ekspertimi, duhet të jenë shkruar nga shtetasja Xxx, krahasuar me dorëshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj.

Aktet që i përkasin dosjes gjyqësore nr. x, datë x të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga sekuestrimi kësaj dosje gjyqësore rezulton se është pasqyruar fakti se shtetasja Xxx ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, kërkesë e cila është regjistruar me nr. x Akti.

Nga aktet e kësaj dosje është pasqyruar fakti se kjo kërkesë është gjykuar nga gjyqtari x me ndihmës gjyqtarët x e x dhe me praninë e sekretares gjyqësore Xxx. Rezulton se është pasqyruar fakti sikur me vendimin nr. xxx, datë 24/12/1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur të urdhërohet ekzekutimi i vendimit civil të formës së pretë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me nr. xxx, datë 23/12/1996.

Në funksion të hetimit është vendosur kryerja e ekspertimit tekniko-grafik në lidhje me dosjen gjyqësore që që i përket vendimit civil nr. xxx datë 24/12/1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Bazuar në aktin e ekspertimit tekniko-grafik nr. 4791, datë 11/05/2017 rezulton se: *“13.Dorëshkrimet në dy kapakët e parë dhe dorëshkrimet në faqen nr. 3 dhe nr. 4, të dosjes gjyqësore nr. xxx Akti, dhe nr.vendimi xxx, datë 24/12/1997 objekt ekspertimi, nuk janë shkruar nga shtetasja Xxx, krahasuar me dorëshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj. 14. Nënshkrimet (firmat) poshtë rekuizitës “Sekretare”, që ndodhen në faqen e pasme të kapakut të dosjes, në faqen e pasme të fletës nr. 4, dhe në vendimin nr. xxx, datë 24/12/1997, doxxxnte këto që ndodhen në dosjen gjyqësore me nr. Akti xx, datë 24/12/1997 dhe nr. Vendimi xxx, datë 24/12/1997, objekte ekspertimi, nuk janë nënshkrime (firma) të shtetases Xxx, krahasuar me modelet e krahasimit të sjella në emër të saj. 15. Nënshkrimet (firmat) poshtë rekuizitës “Gjyqtari”, që ndodhen në faqen e pasme të fletës nr.1, në faqen e pasme të fletës nr. 4, në faqen e pasme të fletës nr.5, si dhe në vendimin nr. xxx, datë 24/12/1997, doxxxnte këto që ndodhen në dosjen gjyqësore me nr. Akti xxx, datë 24/12/1997 dhe nr. Vendimi xxx, datë 24/12/1997, objekte ekspertimi, nuk janë nënshkrime (firma) të shtetasit Xxx, krahasuar me modelet e krahasimit të sjella në emër të tij. 17. Nënshkrimi (firma) poshtë rekuizitës “Kërkuese”, që ndodhet në faqen e parë të dosjes gjyqësore që i përket vendimit nr. xxx, datë 24/12/1997 dhe nënshkrimi (firma) poshtë rekuizitës “Paditëse” që ndodhet në faqen e parë të dosjes gjyqësore që i përket vendimit nr. xxx, datë 23/12/1996 objekte ekspertimi, nuk duhet të jenë nënshkrime (firma) të të njëjtit person dhe paraqesin të njëjtën shkallë floureshence”.*

Nga hetimi rezulton e provuar se pasuria e kthyer përmes vendimit gjyqësor nr. xxx, datë 23/12/1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është regjistruar në regjistrat publik pranë ZVRPP Vlorë, në emër të shtetases Xxx.

Konkretisht rezulton se kjo pasuri fillimisht është regjistruar në dy pasuri, njëra me sipërfaqe 22.000 m² dhe tjetra me sipërfaqe 30.000 m², pasuri për të cilat janë kryer veprime juridike, me qëllim tjetërsimin dhe fshehjen e origjinës së paligjshme të këtyre pasurive. Bazuar në provat shkresore të sekuestruara pranë ZVRPP Vlorë, rezulton se pasuria me sipërfaqe totale 52.000 m² është regjistruar si më poshtë:

- 1.Pasuria nr. x, vol.39, faqe x, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 22.000 m², për të cilën më datën 21/03/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetases Xxx (Kx). Për regjistrimin e kësaj pasurie ka aplikuar më datë 10/01/2013 shtetasi x, i cili ka paraqitur edhe prokurën e posaçme nr. x rep dhe nr. x kol, datë 21/01/2013 të lëshuar nga shtetasja Xxx. Kjo pasuri vijon në vol x, faqe xderi në vol. x, faqe 189-190, pra është ndarë në tre pasuri.

- 2.Pasuria nr. x, vol.x1, faqe x, ZK x e llojit pyll, me sipërfaqe 10.000 m², për të cilën më datën 28/05/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetases Xxx (x). Kjo pasuri vijon në vol. x, faqe x dhe vol. x faqe x duke u ndarë në dy pasuri.

- 3.Pasuria nr. x, vol.x, faqe 10, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 6.000 m², për të cilën më datën 19/06/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetases Xxx xxx, me përshkrimin ndarje pasurie.

- 4.Pasuria nr. x, vol.x, faqe x, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 4.000 m², është regjistruar në emër të shtetases x xxx, me përshkrimin ndarje pasurie.

- 5.Pasuria nr. x, vol.x faqe x, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 7000 m², për të cilën më datën 28/05/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetases Xxx xxx. Kjo pasuri vijon në vol.42, faqe 12.

- 6.Pasuria nr. x, vol.x, faqe 12, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 11.000 m², për të cilën më datën 19/06/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetases Xxx xxx. Rezulton se kjo pasuri është bashkim i pasurive volx faqe x9 dhe vol.x dhe faqe x. Më datën 17/09/2013, kjo pasuri është regjistruar në emër të shtetasit xx, sipas kontratës së dhurimit nr. x rep dhe nr. x kol, datë 11/09/2013. Nga kjo kontratë rezulton se shtetasja Xxx i ka dhuruar shtetasit x sipërfaqen e pronës prej 11.000 m².

- 7.Pasuria nr. x, vol.x, faqe x, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 5000 m², për të cilën më datën 28/05/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetases Xxx xxx. Kjo pasuri vijon në vol. x, faqe x deri në vol. x, faqe x, pra është ndarë në katër pasuri. Rezulton se më datën 01/07/2013, kjo pasuri është regjistruar në emër të shtetasve x në bazë të kontratës së shitjes nr. 1241 rep dhe nr. 637/4 kol, datë 28/05/2013. Sipas kësaj kontrate, shtetasja Xxx u ka shitur shtetasve Px sipërfaqen e pronës prej 5000 m² në shumën prej 31.470.000 Lekë. Për regjistrimin e kësaj kontrate në ZVRPP Vlorë më datën 17/06/2013.

- 8.Pasuria nr. x volx, faqe xZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 2000 m², për të cilën më datën 30/07/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetasit x, sipas kontratës së pjestimit nr. x rep dhe nr. x kol, datë 12/07/2013. Sipas kësaj kontrate, shtetasit x kanë pjestuar në mënyrë vullnetare sipërfaqen e pronës prej 5000 m².

- 9.Pasuria nr. x, vol.x faqe 87 ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 2000 m², për të cilën më datën 30/07/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetasit x, sipas kontratës së pjestimit sipas kontratës së pjestimit nr. x rep dhe nr. x1 kol, datë 12/07/2013. Sipas kësaj kontrate, shtetasit x kanë pjestuar në mënyrë vullnetare sipërfaqen e pronës prej 5000 m². Më datën 23/10/2013, kjo pasuri është regjistruar në emër të shtetasit x, në bazë të kontratës së shitjes nr. x rep dhe nr. x kol, datë 18/09/2013.

- 10.Pasuria nr. x, vol.x, faqe x ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 500 m², për të cilën më datën 30/07/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetasit x, sipas kontratës së pjestimit nr. x rep dhe nr. x kol, datë 12/07/2013. Sipas kësaj kontrate, shtetasit xxxxx kanë pjestuar në mënyrë vullnetare sipërfaqen e pronës prej 5000 m².

- 11.Pasuria nr. x, vol.x, faqe xx9 ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 500 m², për të cilën më datën 30/07/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetasit x, sipas kontratës së pjestimit nr. x rep dhe nr. x kol, datë 12/07/2013. Sipas kësaj kontrate, shtetasit x kanë pjestuar në mënyrë vullnetare sipërfaqen e pronës prej 5000 m².

- 12.Pasuria nr. x, vol.39, faqe xx, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 30.000 m², për të cilën më datën 21/01/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetases Xxx xxx.

Provohet se pasuria me sipërfaqe totale prej 52.000 m², e regjistruar në emër të pandehurës Xxx është regjistruar mbi bazën e aplikimit të shtetasit x, aplikim i paraqitur më datë 10/01/2013, i cili ka paraqitur edhe prokurën e posaçme nr. x rep dhe nr. x kol, datë 21/01/2013, të lëshuar nga e pandehura Xxx. Për regjistrimin e kësaj prone është paraqitur vendimi gjyqësor nr. xxx, datë 23/12/1996 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me aktet e kësaj dosje, si dhe vendimi gjyqësor nr. xxx, datë 24/12/1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me aktet e kësaj dosje. Këto vendime dhe dosjet gjyqësore janë vënë në dispozicion të aplikuesit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë më datë 09/01/2013, sipas nënshkrimit të Kancelares, ndërsa në doxxxntet ndodhet edhe nënshkrimi dhe vula e arkivistes që mban datën 20/12/2012.

Në funksion të hetimit është vendosur kryerja e ekspertimit grafik shkrimi e nënshkrimi në lidhje me doxxxntet: Kontratë dhurimi nr. xrep dhe nr. xkol, datë 11/09/2013, sekuestruar pranë noteres xx, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 17/05/2017; Kontratë shitje nr. x rep dhe nr. x kol, datë 28/05/2013, sekuestruar pranë noteres x, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 19/05/2017; Prokurë e Posaçme nr. x rep dhe nr. x kol, datë 21/01/2013, përmes së cilës shtetasja Xxx ka caktuar si përfaqësues shtetasin x, sekuestruar pranë noteres x, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë

24/05/2017; Kontratë dhurimi nr. xx7 rep dhe nr. x kol, datë x, sekuestruar pranë ZVRPP Vlorë, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 26/05/2017; Kontratë shitje nr. x rep dhe nr. x kol, datë 28/05/2013, sekuestruar pranë ZVRPP Vlorë, përmes

procesverbalit të sekuestrimit datë 26/05/2017, si dhe Prokurë e Posaçme nr. x rep dhe nr. x kol, datë 21/01/2013, sekuestruar pranë ZVRPP Vlorë, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 26/05/2017.

Bazuar në aktin e ekspertimit grafik shkrimi e nënshkrimi nr. x, datë 10/08/2017, rezulton se: "1.Dorëshkrimet e emër mbiemrave "Xxx"; nënshkrimet (firmat) respektive dhe nënshkrimet (firmat), të ndodhura në fundet e faqeve të doxxxnteve, e konkretisht: Kontratë dhurimi nr. x rep dhe nr. x kol, datë 11/09/2013, sekuestruar pranë noteres x, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 17/05/2017; Kontratë shitje nr. xxx rep dhe nr. x kol, datë 28/05/2013, sekuestruar pranë noteres x, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 19/05/2017; Prokurë e Posaçme nr. x rep dhe nr. x kol, datë 21/01/2013, sekuestruar pranë noteres Jetmira Veraj, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 24/05/2017; Kontratë dhurimi nr. x rep dhe nr.

x kol, datë 11/09/2013, sekuestruar pranë ZVRPP Vlorë, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 26/05/2017; Kontratë shitje nr. x rep dhe nr. x kol, datë 28/05/2013, sekuestruar pranë ZVRPP Vlorë, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 26/05/2017, si dhe Prokurë e Posaçme nr. x rep dhe nr. x kol, datë 21/01/2013, sekuestruar pranë ZVRPP Vlorë, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 26/05/2017, objekte ekspertimi, janë shkruar e nënshkruar nga i njëjti person. 2.Dorëshkrimet e emër mbiemrave "Xxx"; nënshkrimet (firmat) respektive dhe nënshkrimet (firmat), të ndodhura në fundet e faqeve të doxxxnteve, e konkretisht: Kontratë dhurimi nr. x rep dhe nr. x kol, datë 11/09/2013, sekuestruar pranë noteres x, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 17/05/2017; Kontratë shitje nr. 1xrep dhe nr. x kol, datë 28/05/2013, sekuestruar pranë noteres x, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 19/05/2017; Prokurë e Posaçme nr. x rep dhe nr. x kol, datë 21/01/2013, sekuestruar pranë noteres x, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 24/05/2017; Kontratë dhurimi nr. x rep dhe nr.

x kol, datë 11/09/2013, sekuestruar pranë ZVRPP Vlorë, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 26/05/2017; Kontratë shitje nr. x rep dhe nr. x kol, datë 28/05/2013, sekuestruar pranë ZVRPP Vlorë, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 26/05/2017, si dhe Prokurë e Posaçme nr. 1xrep dhe nr. x kol, datë 21/01/2013, sekuestruar pranë ZVRPP Vlorë, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 26/05/2017, objekte ekspertimi, nuk përjashtohet mundësia të jenë shkruar e nënshkruar nga shtetasja Xxx, krahasuar me modelet e paraqitura".

Për sa më sipër, me vendimin e Prokurorit "Për njoftimin e akuzës" është marrë në cilësinë e të pandehurës shtetasja Xxx, për kryerjen e veprave penale të "Falsifikimit të doxxxntave" të kryer më shumë se një herë dhe në bashkëpunim dhe "Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale", të parashikuara respektivisht nga nenet 186/2 dhe 287/3 të Kodit Penal.

Pas njohjes së të pandehurës me aktet e procedimit penal, është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkesë dërgimin në gjyq të procedimit penal Nr.x të vitit 2018, kërkesë e cila është pranuar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (gjyqtarit të seancës paraprake) Nr.x datë 09.02.2018.

II.Ligji i zbatueshëm.

Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se: "1.Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor. 2.Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe public brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj".

Neni 1 i Kodit Penal parashikon se: "Ligji penal përcaktin veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të veprave penale ndahen në krime dhe në kundravajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi".

Neni 12 i Kodit Penal parashikon se: "Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën të rritur të katërmbëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç".

Neni 13 i Kodit Penal, parashikon se: "Askush nuk ka përgjegjësi penale kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave apo pasojave të mundshme të ardhjes së tyre, mungon lidhja shkakësore".

Neni 14 i Kodit Penal, parashikon se: "Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si veprim tërësisht i detyrues, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quket me faj personi që e kryen veprën me dashje ose me pakujdesi,".

Neni 149 i Kodit të Procedurës Penale, në të cilin specifikohet se: "Prova janë njoftimet mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprat penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij".

Neni 150 i K.Pr.Penale, parashikon se: "Janë objekt prove faktet që kanë lidhje me akuzën, fajësinë e të pandehurit, caktimin e masave të sigurimit, dënimin dhe përgjegjësinë civile, si dhe faktet nga të cilat varet zbatimi i normave procedurale".

Neni 152 i K.Pr.Penale, parashikon se: "1.Çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre. Çdo provë nënshtrrohet shqyrtimit gjyqësor dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. 2.Gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi. 3.Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indicjet përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën".

III.Vlerësimi i Gjykatës.

Paraprakisht, gjykata vlerëson se, për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të elementëve përbërës të saj të marra së bashku, të cilët janë: (i).Objekti i veprës penale; (ii).Ana objektive; (iii).Subjekti dhe (iv).Ana subjektive. Provueshmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si element themelor për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale.

Gjithashtu, vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjithë elementëve të figurës së saj dhe ajo konsiderohet e kryer apo e konsumuar, kur ekzistojnë të katër elementët figurës së saj dhe në eventualitetin e mungesës së njërit prej këtyre elementëve, do të arrihet

në përfundimin se, figura konkrete e veprës penale nuk është konsumuar, për pasojë autori apo subjekti aktiv i saj, nuk mund të mbajë përgjegjësi penale.

Neni 186 i Kodit Penal, parashikon se: “1.Falsifikimi ose përdorimi i doxxxntave të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet. 2.Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.3. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë doxxxntin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet burgim”.

Objekti juridik i veprës penale të “Falsifikimit të doxxxntave” janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga ligjvënësi, me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e veprimtarisë së ligjshme të organeve të administratës publike apo personave juridikë privatë në lidhje me hartimin, administrimin dhe lëshimin e doxxxntave, nga veprimet e kundraligjshme, shoqërisht të rrezikshme, të kryera me faj dhe të dënueshme penalisht, që synojnë të prekin, çënojnë apo trondisin ligjshmërinë e funksionimit të këtyre organeve.

Objekti material, përfaqëson vetë doxxxntat e falsifikuara, të cilat mund të jenë të ndryshme, me përjashtim të atyre doxxxnt (p.sh doxxxntat shkollore apo shëndetësore) të cilat, ligjvënësi për shkak të rëndësisë që paraqesin, falsifikimin apo përdorimin e tyre e ka ngritur në nivelin e veprës penale, për pasojë nëse do të gjendeshim përpara një rasti të tillë, cilësimi juridik i faktit penal do të bëhej konform dispozitës penale konkrete (p.sh. neni 187 apo 188 të Kodit Penal).

Nga ana objektive, vepra penale e “Falsifikimit të doxxxntave”, do të quhet e konsumuar, nëse realizohet përmes njërës apo formave të mëposhtme:

(i).Falsifikimit të doxxxntave.

(ii).Përdorimit të tyre.

Në lidhje me veprën penale “bijë”, atë të “Falsifikimit të doxxxntave” nga personi që e ka për detyrë, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal, ligjvënësi ka parashikuar si element të anës objektive, vetëm kryerjen e saj përmes veprimit të falsifikimit (pasqyrimin të të dhënave të rreme apo fshehjes së tyre), duke lënë jashtë elementin e përdorimit të doxxxntit të falsifikuar, pikërisht nisur nga cilësitë e posaçme të subjektit aktiv të veprës penale, i cili përfaqëson një person zyrtar, i cili për shkak të ligjit apo aktit nënligjor, është i detyruar të lëshojë doxxxntin.

Në vendimin Nr.113, datë 27.03.2013, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndër të tjera arsyeton se: *“Format e kryerjes se veprës penale të falsifikimit të doxxxntave janë i) hartimi ose ndërhyrja në doxxxnt dhe ii) përdorimi. Në formën e parë të kryerjes është e domosdoshme zbulimi i autorësisë së falsifikimit.”*

Gjykata çmon se, vepra penale e falsifikimit të doxxxntave, futet në kategorinë e veprave penale formale, që do të thotë se ajo do të quhet e konsumuar dhe për pasojë autori i saj do të përgjigjet penalisht, atëherë kur realizohet në njërën nga format e përmendura më sipër, pa patur nevojë për ardhjen apo mundësinë e ardhjes së ndonjë pasoje.

Midis veprimeve të autorit të veprës penale dhe falsifikimit të doxxxntave apo përdorimit të tyre, duhet të ekzistojë lidhja shkakësore në kuptimin që, doxxxnti i falsifikuar apo përdorimi i tij vjen ekskluzivisht dhe vetëm si rezultat i veprimeve të autorit (*nullum crimen, nulla poena sine causa*).

Subjekti, i cili përfaqëson autorin e veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, (në rastet e paragrafit të parë detyrë është subjekt i përgjithshëm, ndërsa në paragrafin e tretë është gjithmonë subjekt i posaçëm, në kuptimin që, përfaqëson një person zyrtar, i cili është i detyruar për shkak të ligjit apo aktit nënligjor që të lëshojë doxxxntin dhe që të mbajnë përgjegjësi penale dhe të jetë subjekt i procedimit dhe gjykimit penal), duhet të plotësojë dy kriteret ekskluzive ligjore:

(i).Kriterin e moshës, pra të ketë mbushur moshën 14 vjeç(ndodhemi përpara një krimi).

(ii).Kriterin e përgjegjshmërisë, pra të jetë i aftë të kontrollojë veprimet e tij si dhe të kuptojë rëndësinë e kryerjes së tyre.

Mungesa qoftë e njërit prej këtyre dy kriterëve, përbën shkak procedural që ndaj subjektit (*autorit të veprës penale*) të mos fillojë procedimi penal dhe nëse ka filluar ai duhet pushuar, duke proceduar me caktimin e masave mjekësore (në rastin e papërgjegjshmërisë) dhe me caktimin e masave edukuese (në rastin e moshës).

Nga ana subjektive, vepra penale e “Falsifikimit të doxxxntave”, në të gjitha format e saj, kryhet vetëm me dashje direkte, në kuptimin që, autori i veprës penale e parashikon dhe e dëshiron falsifikimin apo përdorimin e doxxxntit të falsifikuar, pra ka dijeni rreth falsitetit të doxxxntit që vë në përdorim.[3]

Qëllimi nuk është element cilësues i dispozitës penale konkrete (neni 186), por nisur nga fakti se, nëse ekzistenca apo mungesa e qëllimit ndikon në vetë ekzistencën e figures së veprës penale, e për pasojë edhe në përgjegjësinë penale të autorit të saj, gjykata e çmon me rëndësi t’i referohet jurisprudencës së Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Me Vendimin Nr. 14, datë 04.02.2009, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë shprehet se: *“Vepra penale e falsifikimit të doxxxntave parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, kryhet gjithmonë me dashje direkte të autorit, por krahas kësaj është e domosdoshme që të provohet se falsifikimi është bërë me qëllim fitimi ose çdo interesi tjetër personal, element ky që gjykatat nuk e kanë pasur parasysh në marrjen e vendimeve.”*

Në kuadrin e interpretimit historik, gjykata i referohet me analogji edhe Udhëzimit Nr. 18, datë 07.07.1960 të Plenumit të Gjykatës së Lartë (i cili bën fjalë për veprën penale të falsifikimit të monedhave), sipas së cilit, qëllimi i përfitimit apo çdo lloj interesi tjetër personal, në veprën penale të falsifikimit të monedhave, duhet të ekzistojë gjithmonë, në të kundërt nuk do kemi këtë figurë krimi.

Ligjvënësi, në kuadër të ashpërsimit të politikës penale ndaj figurës së veprës penale të parashikuar në nenin 186 të Kodit Penal, parashikuar në të njëjtën dispozitë penale, si rrethanë cilësuese (që do të thotë se kjo figurë veprë penale, e kryer në njërën nga rrethanat cilësuese, mund të qëndronte eventualisht e parashikuar në një dispozitë të veçantë penale) rastin kur, vepra penale “mëmë”, ajo e “Falsifikimit”, kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur ka sjellë pasoja të rënda.

Në lidhje me rrethanën cilësuese të “përsëritjes”, pra të kryerjes së veprës penale më shumë se një herë, gjykata vlerëson se, për t’u ndodhur përpara kësaj situatë është e nevojshme që, veprimet kriminale të autorit të veprës penale të jenë të tilla që, nga ana objektive,

secili veprim kriminal në drejtim të falsifikimit apo përdorimit të doxxxntit të falsifikuar, duhet të qëndrojë i mëvetësishëm apo autonom nga tjetri dhe në distanca kohore të tilla, nga i cili nxirret përfundimi se, autori i veprës penale ka cënuar dy raporte juridike të mbrojtura nga ligji, përmes dy apo më shumë veprimeve të kundraligjshme dhe të kryera me faj prej tij.

Neni 25 i Kodit Penal parashikon se: “Bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre.”

Në lidhje me rrethanën rënduese të “bashkëpunimit”, ligjvënësi ka sanksionuar në nenin 25 të Kodit Penal, kuptimin e institutit bashkëpunimit, sipas së cilit, kërkohet bashkekzistenca e dy elementeve të rëndësishëm:

(i).Së pari, vepra të jetë kryer nga dy ose më shumë persona.

(ii).Së dyti, kjo vepër të jetë kryer në marrëveshje ndërmjet tyre.

Në lidhje me institutin material të bashkëpunimit, në të dyja format e tij, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në veprimet e unifikues penal Nr.4, datë 15.04.2011, kanë arritur në përfundimin unifikues se: *“Sikurse u analizua më sipër, nga pikëpamja e anës objektive kërkohet që vepra penale të jetë kryer nga jo më pak se dy persona, pra të provohet që në kryerjen e saj të kenë marrë pjesë më shumë se një person, pavarësisht rolit dhe veprimeve të kryera nga secili prej tyre, të cilat çmohen dhe përcaktohen nga gjykatat e faktit referuar rrethanave të faktit, në përputhje me parashikimet e nenit 26 të Kodit Penal. Nga pikëpamja e anës subjektive kërkohet gjithashtu marrëveshja e këtyre personave në kryerjen e veprës penale”*.

Për sa sipër, në të njëjtin vendim unifikues, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se: *“Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se që të ndodhemi në kushtet e bashkëpunimit duhet të bashkekzistojnë si kushte sine qua non:*

1. *dy ose më shumë subjekte (pluralitet personash);*
2. *realizimi i faktit kriminal në të gjithë elementet e tij materiale;*
3. *dhënia e një kontributi rilevant në kryerjen e veprës penale nga secili prej bashkëpunëtorëve;*
4. *ana subjektive, të paktën në formën e saj minimale, që është dhënia e të paktën njërit prej bashkëpunëtorëve bashkëpunuar me të tjerët në kryerjen e faktit kriminal.Kolegjet e Bashkuara theksojnë se karakteristikë e veprës penale të kryer në bashkëpunim është uniteti i anës subjektive të veprës penale të kryer në bashkëpunim. Verifikimi i katër elementeve të mësipërm bën që vepra penale të cilësohet e kryer në bashkëpunim, pavarësisht rolit që ka kryer secili prej bashkëpunëtorëve në realizimin e veprës penale me veprimet apo mosveprimet e tij dhe pavarësisht përgjegjësisë penale që ai mban për këto veprime a mosveprime, përcaktimi i të cilave i takon rrethanave të faktit të provuara në gjykim”*.

Kolegjet e Bashkuara theksojnë se parimi i autonomisë së përgjegjësisë shfaqet në bashkëpunimin e dy ose më shumë personave në kryerjen e veprës penale në formën e dhënies të secilit prej tyre të një kontributi material ose moral në kryerjen e veprës penale. Në këtë drejtim doktrina ka pranuar se për të qenë në kushtet e bashkëpunimit, «... mjafton që pjesëmarrësi të ketë influencë mbi një detaj të veprimit kriminal të ndërmarrë, qoftë lidhur me të mirën apo të drejtën e mbrojtur, qoftë lidhur me planin organizues ...» Në këtë logjikë përfshihen si veprimet *ex ante*, ashtu edhe ato *ex post* të autorit në kryerjen e veprës penale, me kushtin që të kenë ndikuar apo të kenë synuar pasojën kriminale. [4]

Neni 287, pika 1, shkronja “b” e Kodit Penal[5], parashikon se: “1. Pastrimi i produkteve të veprës penale i kryer nëpërmjet d)investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;”

Gjykata vlerëson se, parashikimi i nenit 287, pika 1, shkronja “b” e Kodit Penal, është e njëjtë me parashikimin e nenit 9, shkronja “b” të Konventës së Këshillit të Europës “Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produktive të Krimin dhe Për Financimin e Terrorizmit”[6].

Gjykata vlerëson se, ekzistenca e kësaj figure krimi, është shprehje e politikës penale të ligjvënësit, i cili nisur nga kushtet social ekonomike, formave të ndryshme të shfaqjes së kriminalitetit dhe ratifikimit të instrumentave ndërkombëtare si konventa e lartpërmendur, synon parandalimin dhe goditjen e fenomenit të pastrimit të produkteve të veprës penale.

Neni 1 i Konventës së Këshillit të Europës “Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produktive të Krimin dhe Financimin e Terrorizmit” jep këtë përkufizim: *“Për qëllime të kësaj Konvente: a) “produkt” nënkupton çdo avantazh ekonomik të nxjerrë nga veprat penale. Ky avantazh mund të konsistojë në çdo pasuri, siç përcaktohet në nënparagrafin b të këtij neni;b) “pasuri” nënkupton pasuri të çdo natyre, fizike ose jofizike, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe aktet juridike ose doxxxntet që vërtetojnë një titull ose interes mbi këtë pasuri;”*

Nocionin e “produktit të veprës penale” e konstatojmë edhe në nenin 36 të Kodit Penal, i cili parashikon se: *“1.Konfiskimi detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit: a) të sendeve që kanë shërbyer ose janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale; b) të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe doxxxntet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale;”*.

Gjykata vlerëson se, parashikimi i nenit 36 të Kodit Penal në lidhje me nocionin e “produktit të veprës penale” është i ngjashëm atë të nenit 1 të Konventës së Këshillit të Europës “Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produktive të Krimin dhe Për Financimin e Terrorizmit”, që do të thotë se, produkt të veprës penale, do të kuptojmë çdo avantazh ekonomik i nxjerrë nga një vepër penale, i cili mund të konsistojë në pasuri të çdo natyre si dhe në doxxxnta apo akte juridike që vërtetojnë një titull apo një interes mbi këtë pasuri.

Objekti juridik i kësaj vepre penale përfaqëson tërësinë e marrëdhënieve juridike të vendosura nga ligjvënësi me qëllim garanti funksionimit të rregullt dhe normal të organeve të administratës publike dhe mbrojtja e interesit të shtetit dhe shtetasve nga pastrimi i produkteve të veprës penale.

Objekti material përfaqëson vetë produktin e veprës penale që pastrohet.

Nga ana objektive, kjo vepër penale kryhet përmes veprimeve aktive të autorit të veprës, të cilat bien brenda parashikimeve të n

nga format e parashikuara në nenin 287 të Kodit Penal.

Midis veprimeve të autorit të veprës penale (që synojnë pastrimin e produktit të veprës penale) dhe pasojës apo mundësisë ardhjes së pasojës (pastrimi i produktit të veprës penale), duhet të ekzistojë lidhje shkakësore, në kuptimin që realizimi i pastrimit të produktit të veprës penale (pasoja) të vijë ekskluzivisht dhe drejtpërdrejtë nga veprimet e autorit të veprës penale (shkaku).

Gjykata e çmon me rëndësi në këtë pikë, të evidentojë faktin se midis produktit të veprës penale (vepra penale mëmë) nga njëra dhe veprës penale të pastrimit të këtij produkti (vepra penale bijë), duhet të ekzistojë gjithmonë lidhje shkakësore ekskluzive dhe e domosdoshme (*condicio sine qua non*).

Nga ana subjektive vepra penale e pastrimit të produkteve të veprës penale, kryhet vetëm me dashje direkte^[7], në kuptimin autori i veprës penale e parashikon dhe e dëshiron ardhjen e pasojës (pastrimin e produktit të veprës penale), pra ai ka dijeni se pasuria apo avantazhi ekonomik (shih më sipër përkufizimin) i ardhur nga vepra penale mëmë, përbën produkt të veprës penale dhe dëshiron që këtë produkt ta pastrojë përmes veprimeve aktive të realizuara në njërin nga format e parashikuara në nenin 287 të Kodit Penal. Qëllimi është element cilësues i dispozitës konkrete dhe ai konsiston në: (i).Fshehjen, mbulimin e origjinës së pasurisë ose dhënien e ndihmës, për të shmangur pasojat juridike, që lidhen me kryerjen e veprës penale. (ii).Shmangien nga raportimi sipas ligjit për pastrimin e parave.

Pra, autori i veprës penale, veprimtarinë e tij kriminale e kryen duke e ditur që avantazhet apo pasuria që ai disponon janë pro veprës penale dhe synon t'i pastrojë ato, duke i dhënë trajtën e një pasurie apo avantazhi ekonomik të ligjshëm.

Gjykata çmon se, pastrimi i produkteve të veprës penale nuk përfaqëson një akt të vetëm, por përfshin një proces, i cili synon jo vetëm fshehjen e origjinës së vetë produktit, por edhe mbajtjen nën kontroll të tij dhe ky proces, zakonisht kalon nëpër tre faza, të cilat janë:

(i).Vendosja e produktit të veprës penale;

(ii).Shtresëzimi, i cili përfaqëson përpjekjen e autorit të veprës penale për të realizuar ndarjen e produktit nga burimi kriminal, duke krijuar rrjete komplekse transaksionesh financiare;

(iii).Integrimi, i cili përfaqëson epilogun e procesit të pastrimit të produkteve të veprës penale, në të cilin ky produkt (zakonisht paraja) integrohet në ekonominë e ligjshme dhe bashkohet me asetet e tjera të ligjshme, duke e bërë mjaft të vështirë ndarjen midis pasurisë së ligjshme dhe asaj të paligjshme.

Gjykata vlerëson se, procesi i çmuarjes së provave është proces i ndërlikuar dhe kompleks, pasi përbërës të tij janë komponentë sa juridiko-faktikë, aq edhe të brendshëm, psikologjikë, nga të cilët duhet të udhëhiqet dhe nga i cili ndikohet gjykata në formimin e bindjes së brendshme, pas shqyrtimit prej saj, në tërësi, të provave të administruara gjatë gjykimit, prova këto që duhet të jenë marrë në zbatim të kërkesave të nenit 151 të K.Pr.Penale.

Në analizën e provave, gjykata duhet të niset nga parimet bazë për vlerësimin objektiv të tyre dhe kërkesat e nenit 152 të K.Pr.Penale, sipas të cilit përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të provave i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor, nuk ka vlerë të paracaktuar dhe se ekzistenca e një fakti mund të nxirret edhe nga indicjet, kur ato janë të rëndësishme dhe në përputhje me njëra tjetrën.^[8]

Nga administrimi në tërësi përmes procedurës së gjykimit të shkurtuar të akteve të fashikullit të procedimit penal Nr.501 të vitit 2016, kanë rezultuar të provuara te j çdo dyshimi të arsyeshëm këto rrethana fakti:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ka regjistruar procedimin penal me nr.x viti 2016. Ky procedim penal është regjistruar mbi bazën e vendimit të ndarjes të marrë në kuadër të procedimit penal nr. xtë vitit 2015. Objekt i hetimit të këtij procedimi penal është edhe dosja gjyqësore që i përket vendimit civil nr. xxx, datë 23/12/1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; dosja gjyqësore që i përket vendimit civil nr. xxx, datë 24/12/1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; doxxxntacioni që është administruar në këto dosje gjyqësore, origjina e pasurisë, regjistrimi i kësaj pasurie në ZVRPP Vlorë, si dhe veprimet e kryera në lidhje me këto pasuri. Më datën 22/05/2017 në regjistrat e njoftimit të veprave penale është regjistruar emri i shtetases Xxx, si personi që i atribuohet kryerja e veprave penale të parashikuara nga nenet 186/2 dhe 287 të Kodit Penal.

Nga hetimet paraprake ka rezultuar e provuar se, e pandehura Xxx, ka përfituar përmes doxxxnteve të falsifikuara një sipërfaqe pasurie të paluajtshme prej 52.000 m², e llojit pyll, e cila ndodhet në lagjen "Xxx" të Vlorës. Provohet se kjo pasuri është regjistruar në regjistrat publik pranë ZVRPP Vlorë, si dhe janë kryer veprime juridike tjetërsimi mbi këtë pasuri me qëllim fshehjen e origjinës së paligjshme të pasurisë. Ka rezultuar e provuar se dosja gjyqësore që i përket vendimit civil nr. xxx, datë 23/12/1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe dosja gjyqësore që i përket vendimit civil nr. xxx, datë 24/12/1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, doxxxnte këto që kanë shërbyer për regjistrimin e kësaj pasurie, janë falsifikuar dhe futur në kundërshtim me ligjin në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ky fakt është provuar nga akti i ekspertimit tekniko-grafik nr. xx datë 11/05/2017, si dhe nga të dhënat e administruara pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Agjencisë së Trajtit të Pronave Tiranë. Rezulton e provuar se pas përfitimit të kësaj prone, e pandehura Xxx ka kryer investime në këtë pronë, duke e rrethuar sipërfaqen e pronës prej 30.000 m², si dhe duke ndërtuar pesë kabina me konstruksion druri me sipërfaqe rreth 36 m² dhe me përmasa 6 x 6 m, si dhe një lokal me konstruksion druri.

Ka rezultuar e provuar se përmes vendimit civil nr. xxx, datë 23/12/1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili është tërësisht i falsifikuar, është pasqyruar fakti sikur i janë kthyer në natyrë shtetases Xxx dy parcela të lira, njëra 30.000 m² në lagjen Xxx Vlorë, me kufij të rinj V-Pyill, dhe rrugë, L- Pyll, J-Deti, P-Pyill dhe parcela e dytë me sipërfaqe 22.000 m² në Xxx të Vlorës me kufij të rinj V-Pyill dhe rrugë, L-Pyill, J-Deti, P-Pyill, pronë e cila ndodhet në bregdet në zonën e xx, Vlorë. Rezulton e provuar se edhe vendimi civil nr. xxx, datë 24/12/1997 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është tërësisht i falsifikuar, ku përmes së cilit është pasqyruar fakti sikur është lëshuar urdhëri i ekzekutimit për vendimin nr. xxx, datë 23/12/1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga hetimi është provuar se pasuria e mësipërme me sipërfaqe 52.000 m² është regjistruar më datë 21/03/2013, pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë. Regjistrimi i kësaj pasurie është kryer mbi bazën e doxxxnteve të falsifikuara, e konkretisht dy dosjeve të mësipërme gjyqësore, të cilat i janë shërbyer aplikuesit më datën 09/01/2013, nga arkiva e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas regjistrimit të kësaj pasurie, janë kryer veprime juridike mbi këtë pasuri, e konkretisht ndarje, shitje dhe dhurime, me qëllim

fshehjen e paligjshme të origjinës së kësaj pasurie. Mbi bazën e kërkesës së prokurorit, me vendimin nr.486, datë 29/05/2017, Gjykata e

Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit pasuror "sekuestro preventive", për pasuritë e paluajtshme me sipërfaqe 52.000 m².

Rrethanat e faktet e mësipërme janë provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm nga provat e administruara gjatë hetimeve paraprake, e konkretisht:

Aktet që i përkasin dosjes gjyqësore nr. xxx, datë 23/12/1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të cilat janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale. Nga sekuestrimi kësaj dosje gjyqësore rezulton se është pasqyruar fakti se shtetasja Xxx ka paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, padi e cila është regjistruar me nr. xxx të regjistrimit themeltar. Përmes kësaj padie është kërkuar anulimi i vendimit nr. xxx, datë 09/03/1995 të KKK Pronave Vlorë, duke paditur Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë. Nga aktet e kësaj dosje është pasqyruar fakti se kjo padi është gjykuar nga gjyqtari Xxx me ndihmës gjyqtarët Xxx e Xxx dhe me praninë e sekretares gjyqësore Xxx.

Rezulton se, është pasqyruar fakti sikur me vendimin nr. xxx, datë 23/12/1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur pranimi i padisë se shtetasës Xxx, duke kthyer në natyrë dy parcela të lira, njëra 30.000 m² në lagjen Xxx Vlorë, me kufij të rinj V-Pyll, dhe rrugë, L- Pyll, J-Deti, P-Pyll dhe parcela e dytë me sipërfaqe 22.000 m² në Xxx të Vlorës me kufij të rinj V-Pyll dhe rrugë, L-Pyll, J-Deti, P-Pyll, sipas skicave të ndodhura në dosje.

Provohet se në këtë dosje gjyqësore është administruar si doxxxnt pronësi vendimi nr. xxx, datë 09/03/1995 i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë, bashkë me planimetrinë e pronës. Përmes këtij vendimi është vendosur: "1. Të njohë z. Xxx si trashëgimtare ligjore e vetme të ish pronarit Xxx për pronën, sipërfaqe pyll prej 67.400 m², ndodhur në Xxx Vlorë me kufij të vjetër: V-Caire Belsik, J-Deti, L-Cairi, P-Ranishte. 2. Kompensimin e sipërfaqes 67.400 m² ndodhur në Xxx Vlorë sipas disponibilitetit të këtij Komisioni". Në përmbajtjen e këtij vendimi është përshkruar se vendimi i përket dosjes nr. 2xx, datë 01/03/1995 dhe se prona e njohur është fiksuar në akt njoftuni Zotnimi nr. 73, rendor, datë 27 Qershor 1938.

Bazuar në shkresën nr. 2517/1 prot, datë 16/03/2017 të Agjencisë së Trajtit të Pronave dhe doxxxntacionin e administruar, rezulton se dosja nr. xxx, datë 01/03/1995, e cila përmban vendimin nr. xxx, datë 09/03/1995 të ish-KKKP-së, Këshilli i Rrethit Vlorë, i përket subjektit xx dhe jo subjektit Xxx. Ndërsa sipas shkresës nr. xx prot, datë 02/03/2017 të ZVRPP Vlorë, rezulton se pranë këtij institucioni nuk ekzistojnë akt-njoftuni të veçanta. Nga verifikimi në ideksin alfabetik nga gërma Q-ZH, në gërmen S, nuk figuron pronë në emër të Xxx. Bazuar në shkresën nr. x prot, datë 07/03/2017 të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, rezulton se pranë këtij institucioni nuk është administruar doxxxnti Akt Njoftuni Zotnimi me numër renduer x, datë x në emër të Xxx.

Në funksion të hetimit është vendosur kryerja e ekspertimit tekniko-grafik në lidhje me dosjen gjyqësore që që i përket vendimit civil nr. xxx datë 23/12/1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Bazuar në aktin e ekspertimit tekniko-grafik nr. x, datë 11/05/2017 rezulton se: "1.Dorëshkrimet në kapakun parë dhe dorëshkrimet nga faqja nr.10 deri në faqen nr. 21, të dosjes gjyqësore nr. xxx, datë regjistrimi 10/04/1996 dhe nr.vendimi xxx, datë 23/12/1996 objekt ekspertimi, nuk janë shkruar nga shtetasja Xxx, krahasuar me dorëshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj. 2.Nënshkrimet (firmat) poshtë rekuizitës "Sekretare", që ndodhen në faqen e pasme të kapakut të dosjes, në faqen e pasme të fletës nr. x, në faqen e pasme të fletës nr. 14, në faqen e pasme të fletës nr.

15, në faqen e pasme të fletës nr. 17, në fletën nr. 19, si dhe në fletën nr. 21, doxxxnte këto që ndodhen në dosjen gjyqësore me nr. Regj. Them. xxx, data e regjistrimit 10/04/1996 dhe nr.vendimi xxx, datë 23/12/1996 objekte ekspertimi, nuk janë nënshkrime (firma) të shtetasës Xxx, krahasuar me modelet e krahasimit të sjella në emër të saj. 3.Nënshkrimet (firmat) poshtë rekuizitës "Gjyqtari", që ndodhen në faqen nr. 8, në faqen e pasme të fletës nr. 11, në faqen e pasme të fletës nr.12, në fletën nr. 14, në faqen e pasme të fletës nr. 15, në faqen e pasme të fletës nr. 17, në fletën nr. 19, si dhe në fletën nr. 21, doxxxnte këto që ndodhen në dosjen gjyqësore me nr. Regj. Them. xxx, data e regjistrimit 10/04/1996 dhe nr.vendimi xxx, datë 23/12/1996 objekte ekspertimi, nuk janë nënshkrime (firma) të shtetasit Xxx, krahasuar me modelet e krahasimit të sjella në emër të tij. 4.Nënshkrimi (fimra) poshtë rekuizitës "Gjyqtari" në doxxxntin vendim nr. xxx, datë 23/12/1996 të dosjes gjyqësore me nr. Regj. Them. xxx data e regjistrimit 10/04/1996, objekt ekspertimi, nuk është nënshkrim (firmë) i/e shtetasit Xxx, krahasuar me modelet e krahasimit të sjella në emër të tij.

5.Nënshkrimi (firma) poshtë rekuizitës "Sekretare", në doxxxntin vendim nr. xxx, datë 23/12/1996 të dosjes gjyqësore me nr. Regj. Them. xxx, data e regjistrimit 10/04/1996, objekt ekspertimi, nuk është nënshkrim (firmë) i/e shtetasës Xxx, krahasuar me modelet e krahasimit të sjella në emër të saj".

Në funksion të hetimit është vendosur kryerja e ekspertimit grafik në lidhje me dosjen gjyqësore me nr. akti xxx, data e regjistrimit x dhe nr. vendimi xxx, datë x, me kërkues Xxx x dosjen gjyqësore me nr. Regj. Them xxx, data e regjistrimit 10/04/1996 dhe nr. vendimi xxx, datë x, me kërkues Xxx x numratorin civil ku gjenden të pasqyruara vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për periudhën nga muaji nëntor i vitit 1996, vitit 1997 dhe vitit 1998; regjistrin themeltar i vitit 1996, që ka në përbërje të dhënat e vendimit nr. xxx, datë x, i cili ka nr. Themeltar xxx, me datë regjistrimi

x, si dhe regjistrin themeltar i vitit 1997, që ka në përbërje të dhënat e vendimit nr. x, datë x i cili ka nr. Themeltar x, me datë regjistrimi x.

Bazuar në aktin e ekspertimit grafik nr. x, datë 22/08/2017, rezulton se: "1.Dorëshkrimet në doxxxntet e plotësuar nga sekretarja gjyqësore në fletët e numërtuara "10" deri "21", të dosjes gjyqësore me nr. Regj. Them. xxx, datë regjistrimi 10.04.96 dhe numër vendimi xxx, datë 23.12.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, objekt ekspertimi, nuk duhet të jenë shkruar nga shtetasja Xxx, krahasuar me dorëshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj. 2.Nënshkrimet (firmat) në doxxxntet e nënshkruara nga sekretarja gjyqësore të dosjes gjyqësore me nr.Regj. Them xxx, datë regjistrimi 10.04.96 dhe numër vendimi xxx, datë 23.12.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, objekt ekspertimi, nuk janë nënshkrime të shtetasës Xxx, krahasuar me nënshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj. Nëse këto nënshkrime janë plotësuar ose jo nga shtetasja

Xxx, nuk mund të konkludojmë. 3.Dorëshkrimet në doxxxntet e plotësuar në sekretarja gjyqësore, në fletët e numërtuara "3" deri "5" të dosjes gjyqësore me nr. Regj. Them xxx, datë 24.12.97 dhe nr. vendimi xxx, datë 24.12.1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, objekt ekspertimi, duhet të jenë shkruar nga shtetasja Xxx, krahasuar me dorëshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj. 4.Nënshkrimet (firmat) në doxxxntet e nënshkruara nga sekretarja gjyqësore të dosjes gjyqësore me nr. Regj. Them xxx, datë 24.12.97 dhe nr. vendimi xxx, datë 24.12.1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, objekt ekspertimi, nuk janë nënshkrime të shtetasjes Xxx, krahasuar me nënshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj. Nëse këto nënshkrime janë plotësuar ose jo nga shtetasja Xxx, nuk mund të konkludojmë. 5.Dorëshkrimet që ndodhen në regjistrin e emërtuar "Numratori civil", e konkretisht në rreshtin e faqes që pasqyrojnë të dhënat e vendimit nr. xxx, datë 23/12/1996, objekt ekspertimi, duhet të jenë shkruar nga shtetasja Xxx, krahasuar me dorëshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj. 6.Dorëshkrimet që ndodhen në regjistrin e emërtuar "Numratori civil", e konkretisht në rreshtin e faqes që pasqyrojnë të dhënat e vendimit nr. 960, datë 29/12/1996, objekt ekspertimi, duhet të jenë shkruar nga shtetasja Xxx (xx krahasuar me dorëshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj. 7.Fleta me Nr.Rendor xxx, datë e regjistrimit 10.04.96, që ka në përbërje të dhënat e vendimit xxx, datë 23.12.96 (fleta e fundit e këtij regjistri)m në Regjistrin Themeltar të vitit 1996, nuk është me të njëjtat përmasa me fletët e tjera të regjistrin dhe nuk është e lidhur me fletët e tjera të regjistrin. 8.Në plotësimin e dorëshkrimeve që kanë në përbërje të dhënat e vendimit nr. xxx, datë 23/12/1996, në fletën me nr.Themeltar xxx, datë regjistrimi 10.04.1996 (fleta e fundit e këtij regjistri), në Regjistrin Themeltar të vitit 1996, objekt ekspertimi, nuk u identifikuan ndërhyrje falsifikuese si shtesa, korrigjime, fshirje, etj.

9.Dorëshkrimet që kanë në përbërje të dhënat e vendimit nr. xxx, datë 23/12/1996, në faqen me Nr. Rendor xxx, datë regjistrimi 10.04.1996 (fleta e fundit e këtij blloku) në Regjistrin Themeltar të vitit 1996, objekt ekspertimi, duhet të jenë shkruar nga shtetasja Xxx, krahasuar me dorëshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj. 10.Dorëshkrimet që kanë në përbërje të dhëna te vendimit nr. 960, datë 29/12/1997, në faqen me Nr.Rendor 1210, data e regjistrimit 2.9.97, në Regjistrin Themeltar i vitit 1997, objekt ekspertimi, duhet të jenë shkruar nga shtetasja Xxx, krahasuar me dorëshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj. Aktet që i përkasin dosjes gjyqësore nr. xxx, datë 24/12/1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga sekuestrimi kësaj dosje gjyqësore rezulton se është pasqyruar fakti se shtetasja Xxx ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, kërkesë e cila është regjistruar me nr. xxx Akti.

Nga aktet e kësaj dosje është pasqyruar fakti se kjo kërkesë është gjykuar nga gjyqtari Xxx me ndihmës gjyqtarët Xxx e Xxx dhe me praninë e sekretares gjyqësore Xxx. Rezulton se është pasqyruar fakti sikur me vendimin nr. xxx, datë 24/12/1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur të urdhërohet ekzekutimi i vendimit civil të formës së pretë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me nr. xxx, datë 23/12/1996.

Në funksion të hetimit është vendosur kryerja e ekspertimit tekniko-grafik në lidhje me dosjen gjyqësore që që i përket vendimit civil nr. xxx datë 24/12/1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Bazuar në aktin e ekspertimit tekniko-grafik nr. xxx, datë 11/05/2017 rezulton se: "13.Dorëshkrimet në dy kapakët e parë dhe dorëshkrimet në faqen nr. 3 dhe nr. 4, të dosjes gjyqësore nr. xxx Akti, dhe nr.vendimi xxx, datë 24/12/1997 objekt ekspertimi, nuk janë shkruar nga shtetasja Xxx, krahasuar me dorëshkrimet në dosjet e sjella modele krahasimi në emër të saj. 14. Nënshkrimet (firmat) poshtë rekuizitës "Sekretare", që ndodhen në faqen e pasme të kapakut të dosjes, në faqen e pasme të fletës nr. 4, dhe në vendimin nr. xxx, datë 24/12/1997, doxxxnte këto që ndodhen në dosjen gjyqësore me nr. Akti xxx, datë 24/12/1997 dhe nr. Vendimi xxx, datë 24/12/1997, objekte ekspertimi, nuk janë nënshkrime (firma) të shtetasjes Xxx, krahasuar me modelet e krahasimit të sjella në emër të saj. 15. Nënshkrimet (firmat) poshtë rekuizitës "Gjyqtari", që ndodhen në faqen e pasme të fletës nr.1, në faqen e pasme të fletës nr. 4, në faqen e pasme të fletës nr.5, si dhe në vendimin nr. xxx, datë 24/12/1997, doxxxnte këto që ndodhen në dosjen gjyqësore me nr. Akti xxx, datë 24/12/1997 dhe nr. Vendimi xxx, datë 24/12/1997, objekte ekspertimi, nuk janë nënshkrime (firma) të shtetasit Xxx, krahasuar me modelet e krahasimit të sjella në emër të tij. 17. Nënshkrimi (firma) poshtë rekuizitës "Kërkuese", që ndodhet në faqen e parë të dosjes gjyqësore që i përket vendimit nr. xxx, datë 24/12/1997 dhe nënshkrimi (firma) poshtë rekuizitës "Paditëse" që ndodhet në faqen e parë të dosjes gjyqësore që i përket vendimit nr. xxx, datë 23/12/1996 objekte ekspertimi, nuk duhet të jenë nënshkrime (firma) të të njëjtit person dhe paraqesin të njëjtën shkallë floureshence".

Nga hetimi rezulton e provuar se pasuria e kthyer përmes vendimit gjyqësor nr. xxx, datë 23/12/1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është regjistruar në regjistrat publik pranë ZVRPP Vlorë, në emër të shtetasjes Xxx.

Konkretisht rezulton se kjo pasuri fillimisht është regjistruar në dy pasuri, njëra me sipërfaqe 22.000 m² dhe tjetra me sipërfaqe 30.000 m², pasuri për të cilat janë kryer veprime juridike, me qëllim tjetërsimin dhe fshehjen e origjinës së paligjshme të këtyre pasurive. Bazuar në provat shkrese të sekuestruara pranë ZVRPP Vlorë, rezulton se pasuria me sipërfaqe totale 52.000 m² është regjistruar si më poshtë:

1.Pasuria nr. xx vol.x, faqe x, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 22.000 m², për të cilën më datën 21/03/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetasjes Xxx xxx. Për regjistrimin e kësaj pasurie ka aplikuar më datë 10/01/2013 shtetasi x, i cili ka paraqitur edhe prokurën e posaçme nr. x rep dhe nr. xkol, datë 21/01/2013 të lëshuar nga shtetasja Xxx. Kjo pasuri vijon në vol x, faqe xderi në vol. x, faqe x, pra është ndarë në tre pasuri.

2.Pasuria nr. x, vol.x, faqe x, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 10.000 m², për të cilën më datën 28/05/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetasjes Xxx xxx. Kjo pasuri vijon në vol. 42, faqe 10 dhe vol. 42, faqe 11, duke u ndarë në dy pasuri.

3.Pasuria nr. x, vol.x faqe xx, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 6.000 m², për të cilën më datën 19/06/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetasjes Xxx xxx, me përshkrimin ndarje pasurie.

4.Pasuria nr. x, vol.x faqe xxx ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 4.000 m², është regjistruar në emër të shtetasjes x xxx, me përshkrimin ndarje pasurie.

5.Pasuria nr. x, vol.x, faqe x, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 7000 m², për të cilën më datën 28/05/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetasës Xxx xxx. Kjo pasuri vijon në vol.x faqe 1x.

6.Pasuria nr. x, vol.x faqe x, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 11.000 m², për të cilën më datën 19/06/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetasës Xxx xxx. Rezulton se kjo pasuri është bashkim i pasurive vol. x sipas kontratës së dhurimit nr. x rep dhe nr.x kol, datë 11/09/2013. Nga kjo kontratë rezulton se shtetasja Xxx i ka dhuruar shtetasit xx sipërfaqen e pronës prej 11.000 m².

7.Pasuria nr. x, vol.x, faqe x, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 5000 m², për të cilën më datën 28/05/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetasës Xxx xxx. Kjo pasuri vijon në vol. 42, faqe 86-87 deri në vol. 42, faqe 88-89, pra është ndarë në katër pasuri. Rezulton se më datën 01/07/2013, kjo pasuri është regjistruar në emër të shtetasve x, x, në bazë të kontratës së shitjes nr. 1x rep dhe nr. x kol, datë 28/05/2013. Sipas kësaj kontrate, shtetasja Xxx u ka shitur shtetasve x sipërfaqen e pronës prej 5000 m² në shumën prej 31.470.000 Lekë. Për regjistrimin e kësaj kontrate në ZVRPP Vlorë më datën 17/06/2013.

8.Pasuria nr. x, vol.x, faqe x ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 2000 m², për të cilën më datën 30/07/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetasit x, sipas kontratës së pjestimit nr. xrep dhe nr.x kol, datë 12/07/2013. Sipas kësaj kontrate, shtetasit x kanë pjestuar në mënyrë vullnetare sipërfaqen e pronës prej 5000 m².

9.Pasuria nr. x, vol.x faqe x ZK x, e llojit pyll, me sipërfaqe 2000 m², për të cilën më datën 30/07/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetasit x, sipas kontratës së pjestimit sipas kontratës së pjestimit nr. x rep dhe nr.x kol, datë 12/07/2013. Sipas kësaj kontrate, shtetasit x kanë pjestuar në mënyrë vullnetare sipërfaqen e pronës prej 5000 m². Më datën 23/10/2013, kjo pasuri është regjistruar në emër të shtetasit x, në bazë të kontratës së shitjes nr. x rep dhe nr. x kol, datë 18/09/2013.

10.Pasuria nr. x, vol.42, faqe x ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 500 m², për të cilën më datën 30/07/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetasit x, sipas kontratës së pjestimit nr. 1675 rep dhe nr. 877/1 kol, datë 12/07/2013. Sipas kësaj kontrate, shtetasit x kanë pjestuar në mënyrë vullnetare sipërfaqen e pronës prej 5000 m².

11.Pasuria nr. x vol.x, faqe x ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 500 m², për të cilën më datën 30/07/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetasit x, sipas kontratës së pjestimit nr. 1675 rep dhe nr. 877/1 kol, datë 12/07/2013. Sipas kësaj kontrate, shtetasit x kanë pjestuar në mënyrë vullnetare sipërfaqen e pronës prej 5000 m².

12.Pasuria nr. 3xxx, vol.xx, faqe x, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 30.000 m², për të cilën më datën 21/01/2013 është lëshuar çertifikata e pronësisë në emër të shtetasës Xxx xxx.

Provohet se pasuria me sipërfaqe totale prej 52.000 m², e regjistruar në emër të pandehurës Xxx është regjistruar mbi bazën e aplikimit të shtetasit x, aplikim i paraqitur më datë 10/01/2013, i cili ka paraqitur edhe prokurën e posaçme nr. x rep dhe nr. xx kol, datë 21/01/2013, të lëshuar nga e pandehura Xxx. Për regjistrimin e kësaj prone është paraqitur vendimi gjyqësor nr. xxx, datë 23/12/1996 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me aktet e kësaj dosje, si dhe vendimi gjyqësor nr. xxx, datë 24/12/1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me aktet e kësaj dosje. Këto vendime dhe dosjet gjyqësore janë vënë në dispozicion të aplikuesit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë më datë 09/01/2013, sipas nënshkrimit të Kancelares, ndërsa në doxxxntet ndodhet edhe nënshkrimi dhe vula e arkivistes që mban datën 20/12/2012.

Në funksion të hetimit është vendosur kryerja e ekspertimit grafik shkrimi e nënshkrimi në lidhje me doxxxntet: Kontratë dhurimi nr. x rep dhe nr. xkol, datë 11/09/2013, sekuestruar pranë noteres x, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 17/05/2017; Kontratë shitje nr. x rep dhe nr. x kol, datë 28/05/2013, sekuestruar pranë noteres x, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 19/05/2017; Prokurë e Posaçme nr. x rep dhe nr. x kol, datë 21/01/2013, përmes së cilës shtetasja Xxx ka caktuar si përfaqësues shtetasin x sekuestruar pranë noteres x, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 24/05/2017; Kontratë dhurimi nr. x rep dhe nr. x kol, datë 11/09/2013, sekuestruar pranë ZVRPP Vlorë, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 26/05/2017; Kontratë shitje nr. xrep dhe nr. x4 kol, datë 28/05/2013, sekuestruar pranë ZVRPP Vlorë, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 26/05/2017, si dhe Prokurë e Posaçme nr. x rep dhe nr. x kol, datë 21/01/2013, sekuestruar pranë ZVRPP Vlorë, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 26/05/2017.

Bazuar në aktin e ekspertimit grafik shkrimi e nënshkrimi nr. x, datë 10/08/2017, rezulton se: *“1.Dorëshkrimet e emër mbiemrave “Xxx”; nënshkrimet (firmat) respektive dhe nënshkrimet (firmat), të ndodhura në fundet e faqeve të doxxxnteve, e konkretisht: Kontratë dhurimi nr. xrep dhe nr. x kol, datë 11/09/2013, sekuestruar pranë noteres x, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 17/05/2017; Kontratë shitje nr. x rep dhe nr. xkol, datë 28/05/2013, sekuestruar pranë noteres x, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 19/05/2017; Prokurë e Posaçme nr. xrep dhe nr. xkol, datë 21/01/2013, sekuestruar pranë noteres x, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 24/05/2017; Kontratë dhurimi nr. 1xrep dhe nr. x kol, datë 11/09/2013, sekuestruar pranë ZVRPP Vlorë, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 26/05/2017; Kontratë shitje nr. xrep dhe nr. x, datë 28/05/2013, sekuestruar pranë ZVRPP Vlorë, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 26/05/2017, si dhe Prokurë e Posaçme nr. 163 rep dhe nr. 78/2 kol, datë 21/01/2013, sekuestruar pranë ZVRPP Vlorë, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 26/05/2017, objekte ekspertimi, janë shkruar e nënshkruar nga i njëjti person. 2.Dorëshkrimet e emër mbiemrave “Xxx”; nënshkrimet (firmat) respektive dhe nënshkrimet (firmat), të ndodhura në fundet e faqeve të doxxxnteve, e konkretisht: Kontratë dhurimi nr. x rep dhe nr. x kol, datë 11/09/2013, sekuestruar pranë noteres x, përmes*

procesverbalit të sekuestrimit datë 17/05/2017; Kontratë shitje nr. x rep dhe nr. x kol, datë 28/05/2013, sekuestruar pranë noterës x përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 19/05/2017; Prokurë e Posaçme nr. x rep dhe nr. x kol, datë 21/01/2013, sekuestruar pranë noterës xx, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 24/05/2017; Kontratë dhurimi nr. xx rep dhe nr.

x kol, datë 11/09/2013, sekuestruar pranë ZVRPP Vlorë, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 26/05/2017; Kontratë shitje nr. x rep dhe nr. x kol, datë 28/05/2013, sekuestruar pranë ZVRPP Vlorë, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 26/05/2017, si dhe Prokurë e Posaçme nr. x rep dhe nr. x kol, datë 21/01/2013, sekuestruar pranë ZVRPP Vlorë, përmes procesverbalit të sekuestrimit datë 26/05/2017, objekte ekspertimi, nuk përjashtohet mundësia të jenë shkruar e nëshkruar nga shtetasja Xxx, krahasuar me modelet e paraqitura.”.

Këto rrethana fakti u provuan tej çdo dyshimi të arsyeshëm nga çmuarja në unitet midis tyre, pa i dhënë asnjërës prej tyre vlerë të paracaktuar, e të gjitha akteve të procedimit penal Nr.501 të vitit 2016, të cilat për shkak të procedurës së posaçme të gjykimit të shkurtuar morën vlerën e provave, pa iu nënshtruar debatit gjyqësor kontradiktor dhe konkretisht:

- Vendimi për këqyrjen e vendeve, datë 22/06/2017, procesverbali i këqyrjes së vendeve, datë 27/06/2017, si dhe tabela fotografike;
- Procesverbali për sekuestrimin e doxxxnteve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, datë 10/06/2016, bashkë me doxxxntet e sekuestruara e konkretisht aktet që i përkasin dosjes gjyqësore me nr. xxx, datë 23/12/1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
- Procesverbali për sekuestrimin e doxxxnteve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, datë 07/03/2017, bashkë me doxxxntet e sekuestruara e konkretisht aktet që i përkasin dosjes gjyqësore me nr. xxx5, datë 24/12/1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
- Procesverbali për sekuestrimin e doxxxnteve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, datë 26/05/2017, bashkë me doxxxntet e sekuestruara e konkretisht Numratori Civil, , Regjistri Themeltar i vitit 1996, si dhe Regjistri Themeltar i vitit 1997;
- Procesverbali për sekuestrimin e doxxxnteve pranë ZVRPP Vlorë, datë 07/03/2017, bashkë me doxxxntet e sekuestruara e konkretisht e gjithë praktika e regjistrimit të pasurisë në emër të shtetasës Xxx, si dhe praktikat e pasurive në lidhje me veprimet juridike të kryera për këtë pasuri;
- Procesverbali për sekuestrimin e doxxxnteve pranë shtetasit x, datë 29/06/2017, bashkë me doxxxntet e sekuestruara;
- Procesverbali për sekuestrimin e doxxxnteve pranë noterës x, datë 17/05/2017, bashkë me doxxxntet e sekuestruara;
- Procesverbali për sekuestrimin e doxxxnteve pranë noterës x datë 19/05/2017, bashkë me doxxxntet e sekuestruara;
- Procesverbali për sekuestrimin e doxxxnteve pranë x, datë 24/05/2017, bashkë me doxxxntet e sekuestruara;
- Procesverbali për sekuestrimin e doxxxnteve pranë kompanisë x datë 16/06/2017, bashkë me doxxxntet e sekuestruara;
- Akti i ekspertimit tekniko-grafik dorëshkrimi nr. 4791, datë 11/05/2017, bashkë me tabelën fotografike;
- Akti i ekspertimit grafik shkrimi nr. 8721, datë 10/08/2017, bashkë me tabelën fotografike;
- Akti i ekspertimit grafik nr. 9176, datë 22/08/2017, bashkë me tabelën fotografike;
- Doxxxntet e administruara pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë, përmes shkresës nr. x prot, datë 02/03/2017;
- Doxxxntet e administruara pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë, përmes shkresës nr. x prot, datë 16/03/2017;
- Doxxxntet e administruara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Tiranë, përmes shkresës nr. x prot, datë 07/03/2017;
- Doxxxntet e administruara pranë ZVRPP Vlorë, përmes shkresës nr. x prot, datë 02/03/2017;
- Procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e doxxxnteve pranë ZVRPP Vlorë, datë 03/04/2017, bashkë me doxxxntet e administruara;
- Procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e doxxxnteve, datë 29/06/2017, pranë shtetasit x, bashkë me doxxxntet e administruara;
- Të dhënat bankare të administruara pranë të gjitha bankave të nivelit të dytë
- Procesverbali për marrjen e të dhënave nga perosni që ka dijeni për veprën penale, datë 29/06/2017, nga shtetasi x;
- Procesverbali për marrje ne të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, nga shtetasja Xxx, datë 30/06/2017 dhe datë 03/07/2017 dhe datë 08/09/2017;
- Akte të tjera të këtij fashikulli të procedimit penal.

Gjykata çmon se, nga shqyrtimi në tërësi i provave shkresore dhe shkencore, akteve të fashikullit të procedimit penal nr.x të vitit 2016(*ut supra*), të cilat duke proceduar me ritin e gjykimit të shkurtuar shndërrohen në fashikull gjykimi për gjykatën, ka rezultuar e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se, e pandehura Xxx, në marrëveshje me persona të pidentifikuar (*për të cilët është ndarë procedimi penal dhe po zhvillohen hetime*), përmes veprimeve aktive të kundraligjshme, të cilat nga ana objektive, kanë konsistuar në përdorimin më shumë se një herë, në distanca të shpëutura kohore të doxxxntave të falsifikuar dhe konkretisht vendimit Nr.xxx, datë 23.12.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe vendimit Nr.xxx, datë 24.12.1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me anën e së cilëve është vendosur kthimi në natyrë në favor të pandehurës i një sipërfaqe prej 52.000 m² tokë pyll, ndodhur në fshatin x, Vlorë, duke patur dijeni në lidhje me falsitetin dhe përmbajtjen e pavërtetë të këtyre doxxxntave, ka konsumuar të katër elementët e figurës së veprës penale të “Falsifikimit të doxxxntave” më shumë se një herë dhe në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, për pasojë ajo duhet të deklarohet fajtores në lidhje me këtë figurë krimi.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga ana e mbrojtësit të pandehurës për pushimin e çështjes penale, për shkak të plotësimit të afatit të parashkrimit të ndjekjes penale, gjykata vlerëson se, ky pretendim është i pabazuar në prova dhe në ligj dhe si i tillë duhet rrëzuar. Ka rezultuar e provuar se, pasuria me sipërfaqe totale prej 52.000 m², e regjistruar në emër të pandehurës Xxx është regjistruar mbi bazën e aplikimit të shtetasit x, aplikim i paraqitur më datë 10/01/2013, i cili ka paraqitur edhe prokurën e posaçme nr. x rep dhe nr. xkol, datë 21/01/2013, të lëshuar nga e pandehura Xxx, për pasojë, duke qënë se, doxxxntat e falsifikuara (*vendimet gjyqësore si më sipër*), rezultojnë të jenë përdorur nga e pandehura në muajin Janar të vitit 2013 dhe nga kjo periudhë kohore deri në momentin e marrjes së pandehur të shtetasës Xxx, nuk rezulton të ketë kaluar afati 5(pesë) vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale, i parashikuar nga neni 66/ç i Kodit Penal.

Në lidhje me akuzën për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 287/3 i Kodit Penal, gjykata vlerëson se, nisur nga të

e veprimeve të kundraligjshme të pandehurës x xxx, të cilat nga ana objektive kanë konsistuar në kryerjen e veprimeve juridike mbi pasurinë produkt të veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal dhe konkretisht sipërfaqe prej 52.000 m² tokë pyll, ndodhur në fshatin x, Vlorë, si ndarje, tjetërsime dhe dhurime, me qëllimin e vetëm fshehjen e origjinës së paligjshme të kësaj pasurie. ka vend për ndryshimin e kualifikimit juridik të faktit penal, për të cilin është akuzuar dhe sjellë për gjykim e pandehura, nga ajo për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 287/3 i Kodit Penal, përkatësisht në figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 287/1/b i Kodit Penal, duke i dhënë atij një përcaktim tjetër nga ai i bërë nga ana e organit të akuzës.

Në lidhje me elementin e anës objektive, të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 287/3 i Kodit Penal, pasojën e rën të ardhur si rezultat i veprimeve të kundraligjshme të autorit të veprës penale, gjykata vlerëson se, ndodhemi përpara një nocioni ligjor të papërcaktuar, elaborimi i të cilit duhet të realizohet nga jurisprudenca përkatëse, duke patur në konsideratë, për sa është e mundur dhe aktuale, parashikimet e vendimit unfikues penal si më sipër.

Gjithsesi, pavarësisht sa sipër, gjykata vlerëson se, në lidhje me sqarimin e terminologjisë së përdorur nga ligjvënësi, në nenin 2 të Kodit Penal, "*pasojë e rëndë*", në drejtim të përgjegjësisë penale të autorit të veprës penale, e cila duhet të jetë konkrete, e qartë dhe e shprehur, duhen patur në konsideratë këto elementë objektive dhe subjektive: (i).Vlera në treg e objektit material, i cili përfaqëson produktin e veprës penale dhe i cili i nënshtrohet procesit të pastrimit. (ii).Rëndësia e objektit material, në raport me personin apo personat e dëmtuar nga vepra penale e cila ka sjellë produktin përkatës. (iii).Aftësia e subjektit të dëmtuar nga vepra penale, e cila ka sjellë produktin kriminal, për rikuperimin e dëmit të shkaktuar, apo pasojës së ardhur. (iv).Qëndrimin subjektiv dhe shkallën e fajësisë së autorit të veprës penale.

Gjykata vlerëson se, fakti se, pasuritë produkt të veprës penale (*sipërfaqet e tokës*), ndodhen në bregdet dhe fakti se, pjesa më e madhe e sipërfaqes së tyre, është tjetërsuar, pavarësisht se janë rrethana, të cilat duhen marrë në konsideratë, në drejtim të përcaktimit nëse ndodhemi apo jo përpara pasojës së rëndë, nuk mund të merren të shkëputuara dhe të pavlërësuara në unitet edhe me këto rrethana të tjera, me karakter objektiv dhe konkretisht: (i).Vlera monetare konkrete, e përfutur nga ana e të pandehurit Rajmond Mëzi nga transaksionet e kryera prej tij. (ii).ëndrimi subjektiv i mbajtur prej të pandehurit, në lidhje me veprimet e kundraligjshme të kryera prej tij. (iii).Destinacioni juridik dhe faktit i sipërfaqeve të pasurisë, të cilat kanë qënë objekt i transaksioneve respektiv. (iv).Pasojave të kundraligjshme të ardhura në qarkullimin civil, si rezultat i këtyre transaksioneve. (v).Aftësisë juridike dhe faktike për rikuperimin nga ana e subjekteve përkatës të së drejtës civile, të pasojave eventuale të kundraligjshme, të cilat kanë rrjedhur si rezultat i veprimeve juridike përkatëse.

Nisur nga sa sipër, duke qënë se, veprimet e kundraligjshme të kryera nga ana e të pandehurës Xxx, në drejtim të kryerjes së veprimeve juridike të tjetërsimit, në lidhje me pasurinë e llojit pyll me sipërfaqe 52.000 m², ndodhur në fshatin x Vlorë, kanë patur si qëllim fshehjen e origjinës së kundraligjshme të pasurisë produkt të veprës penale, duke zhvendosur të drejta reale mbi të, gjykata vlerëson se, veprimet e të pandehurës, për efekt të përgjegjësisë penale të saj duhet të kualifikohen sipas nenit 287/1/b të Kodit Penal dhe jo sipas nenit 287/3 të Kodit Penal.

Gjykata vlerëson se, nga pikëpamja e anës subjektive, veprimet e të pandehurës Xxx janë kryer me dashje direkte dhe me qëllim përfitimi material për vetë dhe për persona të tjerë, duke ka cënuar ato raporte juridike, të cilat janë vendosur nga ligjvënësi, me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e veprimtarisë së ligjshme të organeve të administratës publike në lidhje me hartimin, administrimin dhe lëshimin e doxxxntave në përgjithësi, dhe në lidhje me hartimin, administrimin dhe lëshimin e doxxxntave zyrtarë nga ana e zyrove noteriale.

E pandehura Xxx, në momentin e kryerjes së veprës penale, e ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe ka qënë e përgjegjshme përpara ligjit penal në lidhje me veprimet e saj shoqërisht të rrezikshme, të kundraligjshme dhe të kryera me faj.

Në arritjen e këtij përfundimi, gjykata i referohet parashikimeve të neneve 149 dhe 152 të K.Pr.Penale, të cilat rregullojnë normojnë procesin e çmuarjes së provave nga ana e gjykatës, në funksion të vërtetësisë dhe fuqisë provuese të secilës prej tyre, pa i dhënë vlerë të paracaktuar asnjërës prej tyre (*shih me lart provat e paraqitura nga ana e organit të akuzës*).

IV.Caktimi i dënimit.

Neni 47 i Kodit Penal parashikon se: "Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e përgjithshme të këtij kodi dhe dënimeve të parashikuara në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese".

Neni 1/c i Kodit Penal përdor termin "*drejtësi e caktimit të fajësisë dhe dënimit*" dhe ky term zberthehet më tej në nenin 47 të paragrafi i dytë i cili parashikon elementët që merr parasysh gjykata në caktimin e dënimit, duke i shërbyer gjithmonë parimit të drejtësisë në caktimin e dënimit.

Ligjvënësi, i ka kushtuar rëndësi caktimit të dëmit penal nga gjykata, jo vetëm në aspektin e dhënies së një dënimi sa më të drejtë dhe proporcional, por edhe në aspektin e qëllimit që ka dënimi penal i përcaktuar në një vendim gjyqësor dhe që lidhet me edukimin dhe rehabilitimin e fajtorit, me parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm si dhe me ndëshkimin e tij.

Në lidhje me këtë moment të së drejtës materiale penale, Gjykata Kushtetuese, në vendimin Nr.19, datë 01.06.2011, ndër të tjera është shprehur se: "Duke pasur parasysh dhe doktrinën e konsoliduar europiane në këtë fushë, konstaton se, që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës, duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën. Në këtë mënyrë, që të mund të ketë një proces riedukativ të suksesshëm, duhet që ndëshkimi penal të perceptohet nga autori i veprës si i drejtë dhe në përpjestim me veprën e kryer. ...dënimi me burgim, konsiston në privimin nga liria dhe si i tillë duhet përdorur si "extrema ratio", parimi i individualizimit përmban në thelb parimin e proporcionalitetit."

Në caktimin e llojit dhe masës së dënimit penal në ngarkim të pandehurës Xxx, gjykata m konsideratë konditat e mëposhtme juridiko-penale:

i.Rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale.Këtu gjykata i referohet këtyre elementëve:

-Së pari, marzhit të dënimit penal të parashikuar nga ligji për veprat penale konkrete. Veprat penale të parashikuara nga nenet 18 dhe 287/1 të Kodit Penal, janë konsideruar nga ligjvënësi si krime, duke u dënuar përkatësisht me burgim nga 6(gjashtë) muaj deri në 4(katër) vjet (neni 186/2) dhe nga 5(pesë) deri në 10(dhjetë) vjet.

-Së dyti, objektin apo raportin juridik të cënuar. Përmes parashikimit në Kodin Penal, të veprave penale të parashikuara nga nenet 186 dhe 287 të Kodit Penal, ligjvënësi ka marrë në mbrojtje të posaçme juridike, ato marrëdhënie juridike, të cilat konsistojnë, së pari në marrëdhëniet juridike të vendosura nga ligjvënësi, me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e veprimtarisë së ligjshme të organeve të administratës publike apo personave juridikë privatë në lidhje me hartimin, administrimin dhe lëshimin e doxxntave dhe së dyti, në marrëdhëniet juridike të vendosura nga ligjvënësi, me qëllim me qëllim garantimin e funksionimit të rregullt dhe normal të organeve të administratës publike dhe mbrojtja e interesit të shtetit dhe shtetasve nga pastrimi i produkteve të veprës penale.

-Së treti, pasojat e ardhura nga veprat penale. Në lidhje me këtë element të anës objektive, gjykata merr në konsideratë faktin nga veprimet e kundraligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme të pandehurës Xxx ka ardhur si pasojë fitimi i pronësisë nga ana e saj dhe personave të tretë, në mënyrë të kundraligjshme përmes përdorimit të doxxntave të falsifikuar, në lidhje me një sipërfaqe toke pyll prej 52.000 m2, ndodhur në fshatin xx Vlorë.

-Së katërti, përhapjen e veprave penale. Referuar dinamikës dhe tendencës së kriminalitetit, këto lloj figurash të veprave penale, rezultojnë me përhapje tepër të madhe në qytetin e Vlorës, duke krijuar pasiguri në raportet juridiko-civile dhe juridiko-administrative, me pasoja në drejtim të interesave të ligjshme të shtetit dhe personave privatë.

ii.Rrezikshmërinë shoqërore të pandehurve. Këtu gjykata i referohet këtyre elementëve:

-Së pari, gjendja familjare. E pandehura Xxx rezulton me gjendje civile "E martuar".

-Së dyti, gjendja gjyqësore. Sipas vërtetimit përkatës të gjendjes gjyqësore, të ndodhur në dosjen gjyqësore, rezulton pandehura Xxx rezulton me gjendje gjyqësore e dënuar.

-Së treti, moshja e të pandehurës. E pandehura Xxx është e moshës 79 vjeçe.

iii.Shkallën e fajit. Veprat penale, për të cilat u deklarua fajtoreshë e pandehura Xxx, nga pikëpamja e subjektive, janë kryer me dashje direkte dhe me qëllim përfitimi material ose jo, për vetë apo persona të tjerë.

iv.Rrethanat lehtësuese. Në lidhje me rrethanat lehtësuese të parashikuara në mënyrë jo shteruese (listuese) nga neni 48 i Kodit Penal, gjykata vlerëson se, ndaj të pandehurës Xxx, nuk rezultoi e provuar asnjëra prej tyre.

Në lidhje me rrethanat lehtësuese, me karakter indikativ, të parashikuara në nenin 49 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se, d marrë në konsideratë moshja e të pandehurës, niveli arsimor i saj, rrethanat familjare, si dhe fakti se, ajo është hetuar në gjendje të lirë.

vi.Rrethanat rënduese. Në rastin objekt gjykimi, gjykata mban në konsideratë faktin se, në ngarkim të pandehurës xxxë xxx, rezultoi e provuar rrethana rënduese e përsëritjes, e parashikuar nga neni 50/ç i Kodit Penal.

Në këto kushte, bazuar në nenet 1/c, 47, 186/2 dhe 287/1/b të Kodit Penal, duke patur në konsideratë kryesore lidhjen logjike strukturore të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit gjyqësor me dispozitivin e tij[9], në funksion të respektimit të parimit të proporcionalitetit në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, gjykata çmon se, e pandehura Xxx, duhet të dënohet ëprkatësisht me 2(dy) vjet burgim për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe me 5(pesë) vjet burgim për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 287/1/b i Kodit Penal.

Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, duke përdorur sistemin e përthithjes, gjykata vlerëson se, ndaj të pandehurës xxx xxx, duhet caktuar një dënim i vetëm, në masën 5(pesë) vjet burgim.

Neni 59 i Kodit Penal[10], parashikon se: "Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.Gjykata urdhëron që i dënuari të përmbushë një apo më shumë detyrime, të parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi. 3.Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata. 4. Afati i provës, me përjashtim të rregullit të parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, është 24 muaj deri në 5 vjet. Afati i provës fillon, nga e nesërmja shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendim për pezullimin e dënimit me burgim. Afati i provës mund të shkurtohet ose zgjatet në varësi të mënyrës së ekzekutimit të provës dhe kushteve personale të të dënuarit, por pa cenuar afatin minimal dhe maksimal të parashikuar në këtë paragraf."

Neni 59 i K.Penal i jep të drejtën gjykatës që, në raste të veçanta, kur jep dënimin me burgim gjer në pesë vjet, të urdhë dënuari të vihet në provë duke u pezulluar ekzekutimi i dënimit, por, në çdo rast, gjykata duhet të ketë parasysh rrezikshmërinë e pakët të personit dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale. Sipas standardeve ndërkombëtare përdorimi i burgimit si formë dënimi duhet kufizuar rreptësisht dhe të jetë një *extrema ratio* në raste të veçanta, atëherë kur nuk mund të zbatohen masa të tjera të përshtatshme. Siç shprehet edhe Këshilli i Evropës, burgimi duhet të zbatohet si masë vetëm "kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin të papërshtatshme për rëndësinë e veprës", dhe duhen bërë përpjekje që të minimizohet përdorimi i masave që e privojnë personin nga liria dhe të zbatohen më shumë të cilat nuk e bëjnë këtë.[11]

Nga interpretimi logjik e literal i kësaj dispozite, së pari evidentohet se zbatimi i nenit 59 të K.Penal është në diskrecion të gjykatës e cila nëse çmon se plotësohet një ose disa nga kushtet e parashikuara nga kjo dispozitë vendos aplikimin e saj. Nga ana tjetër, në mënyrë që të aplikohet kjo dispozitë nga gjykata, duhet që të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet si më poshtë vijon:

Së pari: Të ekzistojë një prej kushteve të renditur në pjesën e parë të paragrafit të parë të kësaj dispozite si rrezikshmëria e pak personit, autorit të veprës, mosha e të gjykuarit, kushtet shëndetësore apo mendore të tij, mënyra e jetesës dhe nevojat që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, të cilët janë kushte alternativë jo kumulativë. Pra, mjafton të evidentohet se ekziston njëri prej tyre sëbashku me kushtin tjetër, të poshtërenditur;

Së dyti: Gjykata të ketë dhënë ndaj të pandehurit, në përfundim të gjykimit, një dënim jo më të lartë se pesë vjet burgim. Pra, ligjvënësi e ka lidhur zbatimin e nenit 59 me masën e dënimit të dhënë nga gjykata (kur jep dënim me burg deri në pesë vjet) dhe jo me atë të parashikuar nga dispozita konkrete e pjesës së posaçme të K.Penal për të cilën është deklaruar fajtor i pandehuri.^[12] Arrihet në këtë konkluzion duke patur parasysh vetë qëllimin e nenit 59 të K.Penal *“ratio legis”*, aplikimi i të cilit lidhet pikërisht me qëllimin riedukues të dënimit penal, i cili në disa raste çmohet se realizohet pa qenë e nevojshme që individi të izohet nga shoqëria. Prandaj kjo dispozitë, veç të tjerash vendos si kriter edhe dhënien e një dënimi deri në pesë vjet burgim duke patur parasysh llojet e veprave për të cilat gjykata mund të caktojë një dënim të tillë, rrezikshmërinë relativisht të ulët të autorit dhe të veprës të cilat prezumohet të jenë çmuar një herë nga gjykata për caktimin e dënimit në bazë të fakteve dhe rrethanave të secilës çështje konkrete, të cilat, nga ana tjetër janë të njejtat fakte dhe rrethana që mbahen parasysh prej saj edhe për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal.

Duke u kthyer në rastin objekt gjykimi, si rrjedhojë logjike e analizës së elementëve juridike të parashikuar nga neni 47 i Kodit në funksion të caktimit të dënimit denal në ngarkim të pandehurës Shqiponjë Emija xxx, gjykata vlerëson se, e pandehura i plotëson kriteret juridiko-penale, për aplikimin e dënimit alternativ, të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal, të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e saj në provë, për arsyet e mëposhtme:

-Së pari, e pandehura është dënuar me 5(pesë) vjet burgim.

-Së dyti, e pandehura nuk paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore. Këtu gjykata mban parasysh këto rrethana: (i).Personalitetin e të pandehurës. (ii).Moshën e madhe të saj (79 vjeçe). (iii).Nivelin arsimor të pandehurës. (iv).faktin se ajo është hetuar në gjendje të lirë.

-Së treti, gjykata vlerëson se, sipas standardeve ndërkombëtare përdorimi i burgimit si formë dënimi duhet kufizuar rreptësisht dhe të jetë një *extrema ratio* në raste të veçanta, atëherë kur nuk mund të zbatohen masa të tjera të përshtatshme. Siç shprehet nga Këshilli i Evropës, *“burgimi duhet të zbatohet si masë vetëm “kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin të papërshtatshme për rëndësinë e veprës”,*^[13] dhe duhen bërë përpjekje që të minimizohet përdorimi i masave që e privojnë personin nga liria dhe të zbatohen më shumë të cilat nuk e bëjnë këtë.^{[14].[15]}

Neni 30 i Kodit Penal parashikon se: “Për personat që kanë kryer krime ose kundërvajtje penale, bashkë me dënimin kryesor, mund të jepen edhe një ose disa nga këto dënime plotësuese: 1.Ndalimi i të drejtës për të ushtruar funksione publike. 2.Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale.”

Neni 36/1, germet “a” dhe “b”i Kodit Penal parashikon se: “1.Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen e kalimin në favor të shtetit: a)të sendeve që kanë shërbyer ose janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale; b)të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe doxxxntet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale;”.

Gjykata vlerëson se, dënimet plotësuese, krahas dënimeve kryesore (*dënimi me burgim dhe me gjobë*), janë shprehje e pol penale, e cila ndiqet nga ana e ligjvënësit në një situatë të caktuar ekonomike, sociale dhe politike, në drejtim të parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit, si shprehje e shtetit të së drejtës dhe demokratik.

Gjykata vlerëson se, karakteristikë e dënimeve plotësuese është fakti se, ndryshe nga dënimet kryesore, të cilat konsistojnë në privimin e lirisë së autorit të veprës penale, në kuptimin e ngushtë të fjalës, pra të lirisë së lëvizjes (*të dënuarit që ka kryer një vepër penale, p.sh dënimi me burgim*), apo të privimit të pasurisë së tij (*dënimi me gjobë*), ato drejtohen ndaj kategorive të caktuara të marrëdhënieve juridike, të cilat për shkak të cilësive të veçanta të tyre, kanë lidhje *condicio sine qua non* me llojin dhe natyrën e veprës penale të kryer, për të cilën është parashikuar në mënyrë tekstuale në dispozitat e pjesës së posaçme të Kodit Penal, edhe sanksioni penal konkret, si shprehje e parimit të ligjshmërisë (*nullum crimen, nulla poena sine lege scripta*).

Nga interpretimi sistematik i neneve 30, 35 dhe 36 të Kodit Penal, arrihet në përfundimin se, ligjvënësi, duke përdorur si k juridike, mënyrën e kryerjes së veprës penale, cilësitë e posaçme të autorit të veprës penale (*subjektit aktiv*), si dhe përfitimet e karakterit pasuror, të cilat rrjedhin nga vepra penale, për të cilën gjykata ka vendosur deklarin fajtor dhe dënimin e autorit të veprës penale, ka sanksionuar në nenin 35 dhe 36 të Kodit Penal, dy lloje dënimesh plotësuese, me karakter imperativ (detyrues), të cilat duhet të jepen detyrimisht nga gjykata: (i).Së pari, heqjen e së drejtës së autorit të veprës penale për të ushtruar funksione publike (*pa bërë dallime midis tyre*). (ii).Konfiskimin e produkteve të veprës penale.

Në lidhje me dënimin plotësues të parashikuar nga neni 36 i Kodit Penal, gjykata vlerëson se, ai jepet detyrimisht në ato raste (i).Së pari, vepra penale është kryer nga ana e autorit të veprës penale me sende apo mjete të destinuara për kryerjen e saj. (ii).Së dyti, kur nga vepra penale, për të cilën është deklaruar fajtor autori i saj, kanë ardhur përfitime materiale konkrete. Në të dyja këto raste, produkti i veprës penale, konfiskohet dhe kalon në favor të shtetit, nëse nuk është në pronësi të ndonjë personi, i cili nuk ka lidhje me veprën penale të kryer.

Në analizë sistematike të nenit 36 të Kodit Penal dhe nenit 190/1/a të K.Pr.Penale, në pamje të parë (*prima facie*) krijohet idej koncepti i “Produktit të veprës penale” është identike me konceptin e “Provës materiale”. Gjykata vlerëson se, pavarësisht ngjashmërive tepër të mëdha, koncepti i “Produktit të veprës penale” i referohet si rregull, përfitimit të ardhur nga kryerja e veprës penale, i cili ka shërbyer edhe si element nxitës (*motivues*) për autorin e veprës penale, në kryerjen e veprës penale, ndërsa koncepti i “Provës materiale” lidhet pazgjdhshëmrisht me objektin e të provuarit në një proces hetimor apo gjyqësor penal, sepse permes saj synohet individualizimi i

veprës penale të kryer dhe autorit të saj.

Gjykata vlerëson se, e përbashkëta kryesore midis dy nocioneve të sipërcituara, konsiston në faktin që, edhe prova materiale objekt i sekuestros, si mjet për kërkimin e provës (*por që mund të jetë edhe produkt i veprës penale*), por edhe produkti i veprës penale, i cili mund të jetë objekt i sekuestros preventive (*i cili ka vlerën e provës materiale për sa është e nevojshme, por më tepër shfaqet si përfitim nga vepra penale, duke u synuar parandalimi i ardhjes së mëtejshme të pasojave që vijnë nga vepra penale*), në vendimin përfundimtar të gjykatës, nëse nuk konsiderohen sende të kundraligjshme, qarkullimi civil i të cilave është i ndaluar, me përjashtim të vendimit të pafajsisë, konfiskohen dhe kalojnë në favor të shtetit.

Gjykata vlerëson se, përjashtim nga ky rregull, nuk bën as rasti kur ndaj të pandehurit vendoset pushimi i çështjes penale (*neni K.Pr.Penale*), për çfarëdo shkak (*amnistie e ndjekjes penale, vdekje e të pandehurit, shfuqizim i dispozitës penale, apo papërgjegjshmëria e të pandehurit*), sepse në një rast të tillë, qëllimi i ligjvënësit (*ratio legis*), ka qënë ndalimi (stopimi) i mëtejshëm i veprimtarisë hetimore apo gjyqësore të organit të ndjekjes penale apo gjykatës vetëm ndaj personit, autor të veprës penale, por jo ndaj pasojave që kanë ardhur deri në atë fazë të procedimit nga vepra penale e kryer apo e dyshuar se është kryer prej tij, duke përfshirë këtu edhe rastin e vendosjes së sekuestros preventive ndaj produktit të veprës penale (*ose p.sh rastin e shpenzimeve gjyqësore apo të dëmit civil, të shkaktuar nga vepra penale*).

Gjykata vlerëson së, pavarsisht faktit se, ligjvënësi nuk e ka parashikuar në mënyrë eksplicite në dispozitat procedurale, të parashikojnë dhe rregullojnë institutin e masave të sigurimit pasuror, në një rast të tillë, sekuestro preventive shndërrohet *ipso lege* në sekuestro konservative, që do të thotë se, pasuria, produkt i veprës penale objekt i sekuestros konfiskohet dhe kalon në favor të shtetit.

Në rastin objekt gjykimi, ka rezultuar e provuar se, me vendimin Nr.x x të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor V është vendosur sekuestro preventive, në lidhje me pasurinë objekt gjykimi, sipërfaqe toke pyll prej 52.000 m², e ndodhur në fshatin x Vlorë (*sipas ekstremiteteve përkatëse në vendimin e gjykatës*), e cila përfaqëson edhe produktin e veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, për të cilën e pandehura Xxx u deklarua fajtorë nga ana e gjykatës.

Duke vlerësuar se, pasuria e paluajtshme si më sipër, e ndarë në pasuritë përkatëse, objekte të sekuestros preventive të vendosura nga ana e gjykatës, konsiderohen si produkte të veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, në kuptim të nenit 36/b të Kodit Penal, gjykata çmon se, nisur nga sa sipër u arsyetua, në rastin konkret, duhet disponuar me caktimin e dënimit plotësues të konfiskimit të këtyre pasurive dhe kalimin e tyre në favor (pronësi) të shtetit.

Gjykata, pasi u tërhoq për vendim dhe si u kthye, bazuar në nenet 379 e vijues të K.Pr.Penale, neneve 186/2 dhe 287/1/d të Kodit Penal,

VENDOSI:

1. Deklarimin fajtorë të pandehurës Xxx për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimit të doxxxntave" në bashkëpunim, më shumë se një herë, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 2(dy) vjet burgim.
2. Deklarimin fajtorë të pandehurës Xxx për kryerjen e veprës penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287/1/b i Kodit Penal, dhe dënimin e saj me 5(pesë) vjet burgim.
3. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve, caktimin e një dënimi të vetëm në ngarkim të x xx xxx, me 5(pesë) vjet bugim.
4. Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, urdhërohet zbritja e 1/3 së dënimit për të pandehurën Xxx.
5. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj të pandehurës Xxx dhe vënia e saj në provë për një periudhë kohore prej 4(katër) vitesh, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë vepër tjetër penale.
6. Urdhërohet e pandehura Xxx, që gjatë periudhës së provës, të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Vlorë.
7. Në aplikim të neneve 190/1 dhe 391 të K.Pr.Penale, deklarohet falsiteti i doxxxnteve që i janë bashkuar fashikullit të gjykimit, duke u disponuar në mënyrë respektive për to, dhe konkretisht:
 - (i). Dosja gjyqësore civile me numër vendimi xxx, datë 23/12/1996, numër regjistri themeltar xxx, datë regjistrimi 10/04/1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me paditës Xxx, palë e paditur K.K.K.Pronave të rrethit Vlorë, me objekt anulim vendimi, gjyqyarë Xxx, sekretare gjyqësore Xxx, **deklarohet e falsifikuar, duke mos u urdhëruar asgjësimi i saj**, për faktin se mbajtja e kësaj prove është e nevojshme në kuadër të procedimit penal nr. xxxxtë vitit 2017, në kuadër të të cilit po hetohet mënyra e administrimit të kësaj dosje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe personat që kanë shkruar dhe dorëshkuar në këtë dosje gjyqësore.
 - (ii). Dosja gjyqësore civile me numër vendimi xxx, datë 24/12/1997, numër regjistri xxx, datë 24/12/1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me kërkuese Xxx, **deklarohet e falsifikuar, duke mos u urdhëruar asgjësimi i saj**, për faktin se mbajtja e kësaj prove është e nevojshme në kuadër të procedimit penal nrxx të vitit 2017, në kuadër të të cilit po hetohet mënyra e administrimit të kësaj dosje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe personat që kanë shkruar dhe dorëshkuar në këtë dosje gjyqësore. (iii). Të dhënat e pasqyruara në Nuratorin Civil ku gjenden të pasqyruara vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për periudhën nga muaji nëntor i vitit 1996, i vitit 1997 dhe vitit 1998, e konkretisht të dhënat e pasqyruara në lidhje me vendimet gjyqësore vendimi xxx, datë xx, numër regjistri themeltar xxx, datë regjistrimi x i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe vendimi xxx, datë 24/12/1997, numër regjistri xxx, datë x i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, **deklarohen të falsifikuara duke mos u urdhëruar fshirja e tyre**, për faktin se mbajtja e kësaj prove është e nevojshme në kuadër të procedimit penal nr. x të vitit 2017, në kuadër të të cilit po hetohet mënyra e administrimit të kësaj dosje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe personat që kanë shkruar dhe dorëshkuar në këtë dosje gjyqësore.
 - (iv). Të dhënat e pasqyruara në Regjistrin Themeltar i vitit 1996 në lidhje me të dhënat e vendimit nr. xxx, datë 23/12/1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, **deklarohen të falsifikuara, duke mos u urdhëruar fshirja e tyre**, për faktin se mbajtja e kësaj prove është e nevojshme në kuadër të procedimit penal nr. x të vitit 2017, në kuadër të të cilit po hetohet mënyra e administrimit të kësaj dosje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe personat që kanë shkruar dhe dorëshkuar në këtë dosje gjyqësore.
8. Në bazë të nenit 36/b të Kodit Penal, urdhërohet konfiskimi dhe kalimi në favor të shtetit, duke u fshirë nga regjistri i ZVRPP Vlorë, produktet e veprës penale të "Falsifikimit të doxxxnteve", të cilat janë nën masën e sigurimit të sekuestros preventive me vendimin

nrxxxx, datë x, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e konkretisht të:

- (i).Pasurisë nr. x, vol.x faqe x, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 22.000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx xxx.
- (ii).Pasurisë nr. x, vol.x, faqe x, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 10.000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx. (i ii).Pasurisë nr. x, vol.x, faqe , ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 6.000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx xxx.
- (iv).Pasurisë nr. x, vol.xxx faqe xxxx, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 4.000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx xxx.
- (v).Pasurisë nr. xxx, vol.xxx, faqe xxxx ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 7000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx xxx.
- (vi).Pasurisë nr. xx, vol.xx, faqe x, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 11.000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx xxx dhe xx.
- (vii).Pasurisë nr. xxx, vol.x, faqe x, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 5000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx xxx.
- (viii).Pasurisë nr. xxxxx, vol.xxx, faqe 86 ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 2000 m², regjistruar në emër të shtetaset x . (ix).Pasurisë nr. x, vol.xxxx, faqe xxxx ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 2000 m², regjistruar në emër të shtetaset xxxxx. (x).Pasurisë nr. x, vol.xxxx faqe xxx ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 500 m², regjistruar në emër të shtetaset xxxxxxx . (xi).Pasurisë nr. xxxxx, vol.xxx, faqe xxxxxZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 500 m², regjistruar në emër të shtetaset x. (xii).Pasurisë nr. xxxx, vol.xxxx, faqe xxxxx, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 30.000 m², regjistruar në emër të shtetases xxx xxx.
- 9.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së tij. Për të pandehurën në mungesë, ky afat fillon nga dita e nesërme e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall sot, në Vlorë, më datë 15.11.2018.

GJYQTAR
LAURENT FUÇIA

GJYQTARE
ARBANA SELMANAJ

GJYQTARE
ATALANTA ZEQRIRAJ

GJYQ

SEKRETARE
DOLORES ZEMANAJ

Shpenzimet gjyqësore:

1.Në fazën e hetimeve paraprake=165.000 lekë.

2.Në fazën e gjykimit=1.000 lekë.

Totali: 166.000 lekë.

[1] Neni 403/1 i K.Pr.Penale, ndryshuar me Ligjin Nr.35/2017 parashikon se: "1.Kërkesa për gjykimin e shkurtuar paraqitet nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij me autorizim të posaçëm në seancën paraprake ose në seancë gjyqësore kur procedohet sipas nenit 400 dhe paragrafit 3, të nenit 406/ç, të këtij Kodi, me pasojë mospranimi".

[2] Vendimi unifikues penal Nr.2, datë 29.01.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

[3] Vendimi Nr.113, datë 27.03.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Vendimi Nr.186, datë 05.06.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[4] Vendimi Unifikues Penal Nr.4, datë 15.04.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

[5] Nga një interpretim literal dhe logjik të dispozitës, arrihet në përfundimin se, produktet të cilat synohen të pastrohen mund të vijnë si rezultat i kryerjes së një krimi apo edhe të një kundravajtje penale. Kjo sipas nenit 1 të Kodit Penal, ku parashikohet se: "Veprat penale ndahen në krime dhe në kundravajtje penale."

[6] Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr.9646, datë 27.11.2006 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen, dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe Për Financimin e Terrorizmit."

[7] Neni 15 i Kodit Penal.

[8] Vendimi Nr. 31, datë 31.01.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ku thuhet se "Gjykata vlerëson se dallimi midis provës dhe indicjes qëndron në atë që: nëse e para vërteton në mënyrë të drejtpërdrejtë ekzistencën ose jo të një fakti, e dyta është një rrethanë nga e cila mund të arrihet në një deduksion të logjikshëm, një konkluzion i përafërt mbi ekzistencën ose jo të një fakti."

[9] Vendimi Nr.33, datë 08.12.2005 i Gjykatës Kushtetuese (faqe nr.4).

[10] Ndryshuar me Ligjin Nr.36/2017, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.98, viti 2017.

[11] Vendimi Nr.194, datë 04.07.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[12] Vendimi Nr.151, datë 18.06.2014 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[13] Këshilli i Evropës, Rekomandimi Nr. R (99) 22 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare në lidhje me mbipopullimin e burgjeve, paragrafi 1.

[14] Po aty, paragrafi 14. Duhet inkurajuar përdorimi i masave të cilat nuk e privojnë personin nga liria, sa herë të jetë e mundur, pasi këto po konsiderohen gjithnjë e më shumë si mjete më efektive për trajtimin e shkelësve në shoqëri, dukem përfutur në këtë mënyrë edhe shkelësi edhe shoqëria.

[15] Shiko Vendimin Nr. 99, datë 09.04.2014 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Për këto arsye

Baza Ligjore:x

VENDOSI:

Vendosi:

1. Deklarimin fajtores të pandehurës Xxx për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimit të doxxxntave" në bashkëpunim, më shumë se një herë, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 2(dy) vjet burgim.
2. Deklarimin fajtores të pandehurës Xxx për kryerjen e veprës penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287/1/b i Kodit Penal, dhe dënimin e saj me 5(pesë) vjet burgim.
3. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve, caktimin e një dënimi të vetëm në ngarkim të pandehurës Shqiponjë Eminaj xxx, me 5(pesë) vjet burgim.
4. Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, urdhërohet zbritja e 1/3 së dënimit për të pandehurën Xxx.
5. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj të pandehurës Xxx dhe vënia e saj në provë për një periudhë kohore prej 4(katër) vitesh, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë vepër tjetër penale.
6. Urdhërohet e pandehura Xxx, që gjatë periudhës së provës, të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Vlorë.
7. Në aplikim të neneve 190/1 dhe 391 të K.Pr.Penale, deklarohet falsiteti i doxxxnteve që i janë bashkuar fashikullit të gjykimit, duke u disponuar në mënyrë respektive për to, dhe konkretisht:
 - (i). Dosja gjyqësore civile me numër vendimi xxx, datë 23/12/1996, numër regjistri themeltar xxx, datë regjistrimi 10/04/1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me paditës Xxx, palë e paditur K.K.K.Pronave të rrethit Vlorë, me objekt anulim vendimi, gjyqyarë Xxx, sekretare gjyqësore Xxx, **deklarohet e falsifikuar, duke mos u urdhëruar asgjësimi i saj**, për faktin se mbajtja e kësaj prove është e nevojshme në kuadër të procedimit penal nr. 2159 të vitit 2017, në kuadër të të cilit po hetohet mënyra e administrimit të kësaj dosje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe personat që kanë shkruar dhe dorëshkruar në këtë dosje gjyqësore.
 - (ii). Dosja gjyqësore civile me numër vendimi xxx, datë 24/12/1997, numër regjistri xxx, datë 24/12/1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me kërkuese Xxx, **deklarohet e falsifikuar, duke mos u urdhëruar asgjësimi i saj**, për faktin se mbajtja e kësaj prove është e nevojshme në kuadër të procedimit penal nr. 2159 të vitit 2017, në kuadër të të cilit po hetohet mënyra e administrimit të kësaj dosje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe personat që kanë shkruar dhe dorëshkruar në këtë dosje gjyqësore. (iii). Të dhënat e pasqyruara në Nuratorin Civil ku gjenden të pasqyruara vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për periudhën nga muaji nëntor i vitit 1996, i vitit 1997 dhe vitit 1998, e konkretisht të dhënat e pasqyruara në lidhje me vendimet gjyqësore vendimi xxx, datë 23/12/1996, numër regjistri themeltar xxx, datë regjistrimi 10/04/1996 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe vendimi xxx, datë 24/12/1997, numër regjistri xxx, datë 24/12/1996 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, **deklarohen të falsifikuara duke mos u urdhëruar fshirja e tyre**, për faktin se mbajtja e kësaj prove është e nevojshme në kuadër të procedimit penal nr. 2159 të vitit 2017, në kuadër të të cilit po hetohet mënyra e administrimit të kësaj dosje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe personat që kanë shkruar dhe dorëshkruar në këtë dosje gjyqësore.
 - (iv). Të dhënat e pasqyruara në Regjistrin Themeltar i vitit 1996 në lidhje me të dhënat e vendimit nr. xxx, datë 23/12/1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, **deklarohen të falsifikuara, duke mos u urdhëruar fshirja e tyre**, për faktin se mbajtja e kësaj prove është e nevojshme në kuadër të procedimit penal nr. 2159 të vitit 2017, në kuadër të të cilit po hetohet mënyra e administrimit të kësaj dosje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe personat që kanë shkruar dhe dorëshkruar në këtë dosje gjyqësore.
8. Në bazë të nenit 36/b të Kodit Penal, urdhërohet konfiskimi dhe kalimi në favor të shtetit, duke u fshirë nga regjistri i ZVRPP Vlorë, produktet e veprës penale të "Falsifikimit të doxxxnteve", të cilat janë nën masën e sigurimit të sekuestros preventive me vendimin nr.486, datë 29/05/2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e konkretisht të:
 - (i). Pasurisë nr. 32/446, vol.39, faqe 229, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 22.000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx xxx.
 - (ii). Pasurisë nr. 32/468, vol.41, faqe 188, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 10.000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx. (iii). Pasurisë nr. 32/471, vol.42, faqe 10, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 6.000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx xxx.
 - (iv). Pasurisë nr. 32/472, vol.42, faqe 11, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 4.000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx xxx.
 - (v). Pasurisë nr. 32/469, vol.41, faqe 189, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 7000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx xxx.
 - (vi). Pasurisë nr. 32/473, vol.42, faqe 12, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 11.000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx xxx dhe Artur Rrapushi.
 - (vii). Pasurisë nr. 32/470, vol.41, faqe 190, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 5000 m², regjistruar në emër të shtetases Xxx xxx.
 - (viii). Pasurisë nr. 32/474, vol.42, faqe 86 ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 2000 m², regjistruar në emër të shtetasit Përparim Hasani.
 - (ix). Pasurisë nr. 32/475, vol.42, faqe 87 ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 2000 m², regjistruar në emër të shtetasit Sinan Belaj.
 - (x). Pasurisë nr. 32/477, vol.42, faqe 88 ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 500 m², regjistruar në emër të shtetasit Besim Bala.
 - (xi). Pasurisë nr. 32/476, vol.42, faqe 89 ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 500 m², regjistruar në emër të shtetasit Benard Roshi.
 - (xii). Pasurisë nr. 32/447, vol.39, faqe 230, ZK 8604, e llojit pyll, me sipërfaqe 30.000 m², regjistruar në emër të shtetases Shqiponja Eminaj xxx.
9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërme e shpalljes së tij. Për të pandehurën në mungesë, ky afat fillon nga dita e nesërme e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall sot, në Vlorë, më datë 15.11.2018.

GJYQTAR

LAURENT FUÇIA

GJYQTARE

ARBANA SELMANAJ

ATALANTA ZEQRIRAJ

GJYQ

SEKRETARE

DOLORES ZEMANAJ

SHPENZIMET GJYQESORE

Kërkesëpapia	0
Taksa Gjyqësore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:

Laurent Fuçia